




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT


Prill 2018



Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit, përcakton mënyrën sesi duhet të hartohen Raportet e Vlerësimit të Ndikimit, të miratuar me VKM Nr. 584 datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

Metodologjia është e organizuar në tre pjesë. Pjesa e parë përshkruan kërkesat, qëllimin dhe procesin e drejtimit të VN-së. Pjesa e dytë parashikon metodologjinë standarde dhe përshkrime për secilin hap të procesit të VN-së. Pjesa e tretë parashikon metodologjitë e analizës, si dhe shpjegon procesin e vlerësimit të kostove dhe përfitimeve. Gjithashtu, pjesë integrale e dokumentit janë edhe anekset shoqëruese që përmbajnë informacion, formatet tip dhe mjete për t’u përdorur gjatë procesit të VN-së.

Kjo Metodologji është përgatitur nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore (Njësia e VN-së) në Kryeministri, me mbështetjen e SIGMA-s.



UDHËHEQËS I PROCESIT:

Artur Metani

Artur.Metani@kryeministria.al

Drejtor

Departamenti Rregullator dhe Përputhshmërisë
Kryeministria

KOORDINATORË:

Ornela Shurdhaj

ornela.shurdhaj@kryeministria.al

Jona Josifi

jona.josifi@kryeministria.al

Marsida Omari

marsida.omari@kryeministria.al

Marbona Cuka

marbona.cuka@kryeministria.al

Nertil Jole

nertil.jole@kryeministria.al

Eris Çela

eris.çela@kryeministria.al



Përmbajtja	
Hyrje	4
Përfitimet e vlerësimit të ndikimit	9
Kur nevojitet një vlerësim i ndikimit?	11
Hapat e procesit të zhvillimit të politikave në rastet kur një VN nevojitet	13
Miratimi i vlerësimit të ndikimit	15
Transparenca dhe publikimi i raporteve të vlerësimit të ndikimit	17
Përmbledhje e hapave kryesorë proceduralë në procesin e VN-së	17
Koha që kërkohet për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit	21
Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve	21
Domosdoshmëria e kryerjes së vlerësimit të ndikimit	27
Vlerësimi i ndikimit për projektligjet që transpozojnë Acquis të BE-së	30
Pjesa II: Përgatitja e VN-së	34
Hapi I: Identifikimi i problemit dhe arsytet e ndërhyrjes	34
Hapi 2: Objektivat	40
Hapi 3: Identifikimi i opsioneve	43
Hapi 4: Vlerësimi i opsioneve dhe analizimi i ndikimeve të tyre	45
Hapi 5: Zgjedhja e opsionit më të mirë	58
Hapi 6: Çështje të zbatimit	60

Hapi 7: Faza e shqyrtimit dhe vlerësimit	62
Pjesa III: Metodatat e vlerësimit	64
Analiza e kosto – përfitimit	65
Analiza e kosto - efektivitetit	80
Analiza me shumë kritere	85
ANEKSET	90
Aneksi 1: Modeli tip i raportit të vlerësimit të ndikimit	90
Aneksi 2: Pyetje ndihmëse gjatë përgatitjes së VN-së	100
Aneksi 3: Ndikimi në testin e NVM-ve	105
Aneksi 4: Ndikimi në testin e konkurrencës	106
Aneksi 5: Listë kontrolli për përdorim nga njësia e VN-së në Kryeministri	107

Hyrje

Qeveria shqiptare, nëpërmjet këtij dokumenti ka si objektiv të prezantojë dhe të bëjë të detyrueshëm sistemin e vlerësimit *ex-ante* të politikave kryesore, legjislacionit dhe rregullimeve, për të promovuar dhe forcuar politikëbërjen e bazuar në dëshmi dhe hartimin legjislativ brenda qeverisë qendrore. Realizimi i këtij objektiv vjen në kuadër të një prej prioriteteve thelbësore të reformës në administratën publike, e cila synon të rrisë cilësinë dhe efektivitetin e hartimit të politikave/legjislacionit në Shqipëri dhe të sigurojë se ndërhyrja e qeverisë është e drejtuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative. Realizimi i këtij objektiv do të ndihmojë gjithashtu edhe në rritjen e transparencës dhe të hapjes së procesit të hartimit të politikave të qeverisë.

Kjo Metodologji parashikon alternativat e ndryshme për planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e Vlerësimit të Ndikimit (më poshtë referuar “VN”) në Shqipëri, si dhe ndihmon në përgatitjen e paketës së nevojshme të ndryshimeve legjislative dhe rregullatore, me qëllim ngulitjen e sistemit të VN-së brenda procesit ekzistues të politikëbërjes.

Gjatë hartimit të kësaj Metodologjie janë marrë parasysh parimet, objektivat dhe metodologjitë për zbatimin e VN-së, si më poshtë:

- *Minimizimi i kostove të reformave.* Aplikimi i kostove dhe ndryshimeve minimale në proceset dhe rregullat ekzistuese, në të cilat bazohet procesi i politikëbërjes, për të mundësuar zbatimin e lehtë dhe të shpejtë të tyre.

- *Udhëzimet e VN-së dhe metodologjitë e paraqitura mundësojnë analizimin e politikave si rregullatore ashtu dhe jorregullatore.* Qasja aktuale parashikon vendosjen e një sistemi që mund të aplikohet si për propozimet rregullatore/ligjore, ashtu edhe për iniciativat kryesore politike që janë pjesë e dokumenteve dhe programeve strategjike kombëtare dhe që janë menduar të zbatohen përmes mjeteve jorregullatore. Për këtë arsye, ky dokument i propozuar i referohet një termi të përgjithshëm “Vlerësimi i Ndikimit” dhe jo “Vlerësimi i Ndikimit Rregullator”.
- *Ndryshimet minimale në organizimin institucional brenda qeverisë.* Kjo Metodologji sugjeron përdorimin e organizimit ekzistues ligjor dhe institucional brenda qeverisë qendrore për të menaxhuar dhe mbikëqyrur politikën e re të vlerësimit të ndikimit.
- *Ngritja e kapaciteteve dhe mungesa e aftësive.* Formimi i aftësive dhe i kapaciteteve të nevojshme në kuadër të sistemit të shërbimit civil shqiptar është një element shumë i rëndësishëm. Metodologjia lehtëson hartimin e programit afatgjatë të reformave për të mbështetur ngritjen e kapaciteteve dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave të reja në ministritë e linjës. Programi duhet të hartohet me qëllimin e forcimit të kapaciteteve analitike në çdo ministri. Qëllimi i fazës së parë të reformave është të institucionalizojë kërkesat e VN-së brenda sistemit aktual.
- *Promovimi i kulturës dhe i praktikës së politikëbërjes së hapur dhe transparente.* Kjo Metodologji ka për qëllim të promovojë praktikat e hapura dhe transparente të politikëbërjes duke vendosur theksin në procesin e

konsultimit publik të propozimeve të politikave dhe duke e përdorur atë si një burim të rëndësishëm të provave shtesë për përfundimin e vlerësimit të ndikimit.

Analiza ex-ante e vlerësimit të politikave është një element thelbësor për politikëbërjen e bazuar në dëshmi, e cila çon në rezultate më të mira rregullatore dhe të politikave. VN është i nevojshëm për të gjitha propozimet legislative/rregullatore/të politikave që kërkojnë miratimin e Këshillit të Ministrave dhe që pritet të krijojnë *kosto ose përfitime shtesë* për qytetarët, biznesin, shoqërinë civile etj.

OECD-ja është shprehur se një nga parimet udhëzuese për cilësinë rregullatore është:

..“vlerësimi i ndikimeve dhe shqyrtimi i rregullimeve në mënyrë sistematike për të garantuar që ato të përmbushin objektivat e tyre të synuar në mënyrë efikase dhe efektive në një mjedis të ndryshueshëm dhe kompleks ekonomik e social”.

VN është një proces dhe mjet, i cili ndihmon në zhvillimin e politikave dhe rregullimeve të qeverisë, nëpërmjet:

- Të kuptuarit të përfitimeve, kostove dhe risqeve të një politike publike të propozuar dhe opsioneve më optimale në dispozicion për zbatim;
- Analizimit të problemeve të politikës, arsytimit të ndërhyrjes së qeverisë dhe zhvillimit të objektivave në mënyrë sistematike;

- Ofrimit të dëshmimeve mbi pasojat e mundshme të këtyre opsioneve dhe të hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri, si dhe;
- Marrjes parasysh të pikëpamjeve të një game të gjerë të palëve të interesuara, duke bërë të mundur që hartimi i politikave të jetë më i argumentuar për sa u përket mjeteve me kosto më efektive të arritjes së objektivave të politikave, si dhe transparencës më të madhe dhe llogaridhënies, të cilat nga ana e tyre, ndihmojnë në arritjen e besimit më të madh të publikut ndaj procesit dhe rezultateve të politikave të ndryshme të qeverisë.

VN është një mjet i njohur ndërkombëtarisht dhe shumë i rëndësishëm që kontribuon në procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave/legjislacionit, të bazuar në prova dhe dëshmi të një cilësie të mirë. VN përfshin gjithashtu analizën e të gjitha kostove dhe përfitimeve që mund të sjellin politikat e propozuara, si dhe mbledhjen e të dhënave dhe informacionit mbi pasojat e risqet e mundshme të këtyre politikave. Për këtë qëllim, me rëndësi në këtë proces është dhe përfshirja dhe angazhimi i palëve të interesuara dhe publikut për të dhënë mendimet dhe qëndrimet e tyre.

VN me qëllim përmirësimin e procesit të hartimit legjislativ dhe të politikave ndjek parimet e mëposhtme:

- Transparencën;
- Përgjegjshmërinë;
- Proporcionalitetin;
- Qëndrueshmërinë,
- Drejtimin.

VN shqyrton çështjet e politikës/legjislacionit të prozuar si dhe zgjidhjet e problematikave të ndryshme, të cilat trajtojnë pyetjet në vijim:

- Cila është politika apo problemi që po shqyrtohet?
- Cilat grupe ndikohen nga politika apo problemi?
- Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?
- Çfarë opsionesh po shqyrtohen?
- Cilat janë përfitimet, kostot dhe risqet e pritshme të secilit opsion?
- Cili është opsioni i preferuar dhe pse – cilat dëshmi e mbështesin atë?
- Si do të zbatohet opsioni i preferuar?
- Si do të monitorohen dhe do të vlerësohen efektet e ndryshimeve të politikave pas zbatimit?

VN nuk është:	VN është:
Një shtesë alternativë e një politike apo e legjislacionit.	Një proces në të cilin përdoren metoda të ndryshme të analizës.
Analizë vetëm nga këndvështrimi rregullator.	Analizë nga pikëpamja e shoqërisë në tërësi.
Një mënyrë për të justifikuar ndërhyrjen pasi është miratuar politika ose rregullimi.	Një mënyrë për të analizuar kostot dhe përfitimet e çdo ndryshimi para ndryshimit.

Një zëvendësim i vendimeve politike.	Bazë për marrjen e vendimeve politike.
--------------------------------------	--

Në procesin e VN-së janë të rëndësishme analizat e forta dhe dëshmitë e fuqishme. Megjithatë, burimet që investohen kur ndërmerret një VN (qofshin ato njerëzore, në kohë apo edhe financiare) duhet të jenë në *proporcion* me llojin e politikës që shqyrtohet, ndikimet e pritshme dhe/ose fazën e zhvillimit. Fokusi duhet të jetë në ato politika që mund të kenë ndikim apo pasoja të rëndësishme dhe/ose ku ka një interes të lartë nga palët e interesit. Faktorët që duhet të merren në konsideratë përfshijnë:

- Nivelin e analizave të nevojshme;
- Shkallën e ndikimit të realizuar;
- Fazën e politikës/rregullimit;
- Ndjeshmërinë e politikës/rregullimit;
- Koston e realizimit të analizave të mëtejshme në krahasim me përfitimet që mund të identifikohen.

Përfitimet e vlerësimit të ndikimit

Procesi i VN-së ndihmon qeverinë të marrë vendime më efektive në drejtim të politikëbërjes me qëllim alokimin e burimeve aty ku janë më shumë të nevojshme dhe ku japin rezultate më të larta me kosto më të ulëta. Disa nga këto përfitime janë:

- Sigurimi i një strukture logjike për të planifikuar politikat;
- Sigurimi i informacionit dhe dëshmime/provave shtesë për hartimin e politikave/legjislacionit, duke ndihmuar

ministrinë e linjës që të kenë një pasqyrë të gamës së plotë të opsioneve;

- Identifikimi i përfitimeve, kostove dhe rreziqeve të ndërhyrjeve të mundshme rregullatore, duke i mundësuar atyre krahasimin e drejtpërdrejtë së bashku me veprimet që mund të ndërmerren për të zvogëluar kostot dhe për të zbutur risqet, gjë e cila do të rrisë përfitimin e përgjithshëm të ndryshimit të politikave;
- Ndhurma për të marrë në konsideratë pikëpamjet e një game të gjerë të palëve të interesuara, duke e bërë procesin e zhvillimit të politikave më të fuqishëm dhe më transparent, si dhe duke bërë të mundur shtimin e vlerës nga interesat e jashtme, nëpërmjet marrjes së informacionit dhe njohurive të tyre të specializuara sipas rastit;
- Të menduarit përmes ndikimeve të mundshme dhe duke ndihmuar për harmonizimin e ndërhyrjeve të propozuara të politikave me objektivat e tjerë të qeverisë.
- Sigurimi i një argumenti përse është zgjedhur politika e rekomanduar, duke ndihmuar në këtë mënyrë në ndërtimin e besimit të publikut nëpërmjet llogaridhënies ndaj tij, si dhe;
- Inkurajimi i ministrive përgjegjëse për të menduar mbi rezultatet dhe se si ata do të identifikojnë përmes monitorimit dhe vlerësimit, nëse këto rezultate janë arritur apo jo.

Metodologjia është e organizuar në tri pjesë. Pjesa e parë përshkruan kërkesat, qëllimin dhe procesin e drejtimit të VN-së.

Pjesa e dytë parashikon metodologjinë standarde dhe përshkrime për secilin hap të procesit të VN-së. Pjesa e tretë parashikon metodologjitë e analizës, si dhe shpjegon procesin e vlerësimit të kostove dhe përfitimeve. Aneksat përmbajnë informacion, formatet tip dhe mjete për t'u përdorur gjatë procesit të VN-së.

Kjo Metodologji është përgatitur nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore (Njësia e VN-së) në Kryeministri, me mbështetjen e SIGMA-s.

Pjesa I: Qëllimi dhe procesi i VN-së

Kjo pjesë e Metodologjisë shpjegon procesin e VN-së dhe përcakton qëllimin e VN-së në sistemin shqiptar.

Kur nevojitet një vlerësim i ndikimit?

Të gjitha propozimet legislative, veçanërisht projektligjet, të ndërmarra nga qeveria duhet të kryejnë analizën e plotë të ndikimit, duke përdorur parimet dhe metodologjitë e përcaktuara në këtë dokument, sipas formatit tip të përcaktuar në aneksin 1 të këtij dokumenti.

Gjithashtu, përveç projektligjeve, rekomandohet fort që të gjitha propozimet rregullatore dhe të politikave si dhe dokumentet strategjike, të cilat janë miratuar me akte nënligjore (si Vendimet e Këshillit të Ministrave) dhe të cilat pritet të kenë ndikim të rëndësishëm mbi qytetarët, biznesin, shoqërinë civile etj, të kryejnë procesin e VN-së, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në këtë dokument.

Përrjashtim nga zbatimi i VN-së përbëjnë ato kategori të propozimeve ligjore që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

<i>Kriteri/et</i>
1. Projektakte që trajtojnë çështje, të cilat lidhen me informacionin e klasifikuar shtetëror; çështje të sigurisë kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë.
2. Projektakte që lidhen me situata emergjente, fatkeqësi natyrore apo gjendje të krizës.
3. Projektligje që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomatike, kryesisht ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare apo çështje që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare.
4. Projektakte që lidhen me menaxhimin buxhetor, projektligji për buxhetin vjetor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, projektaktet që lidhen me programimin buxhetor afatmesëm, projektaktet që prekin tatimet dhe tarifatat doganore.
5. Projektakte që prekin legjislacionin penal.
6. Projektakte që kanë efekt zbatimi të përkohshëm dhe kalimtar.

Është në përgjegjësinë e ministrive të linjës të planifikojnë dhe të kryejnë VN për të gjitha propozimet ligjore që ata duan të ndërmarrin. Ministrinë e linjës duhet të fillojnë procesin e përgatitjes së VN-së sa më shpejt të jetë e mundur gjatë procesit

të hartimit të politikës/legjislacionit. Ekipet e politikave në ministri duhet të kryejnë vlerësimet paraprake të të gjitha propozimeve të reja, për të përcaktuar nëse VN kërkohet apo jo, bazuar edhe në kriteret e përjashtimit të VN.

Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore (Njësia e VN-së) në Kryeministri, duhet të miratojë çdo rast përjashtimi, të bazuar në arsyetimin dhe dëshmitë e paraqitura nga ministritë. Nëse politika/legjislacioni i propozuar plotëson një nga kriteret e përjashtimit më sipër, ekipi i politikave duhet t'i paraqesë me shkrim Njesisë së VN-së në Kryeministri, arsyetimin mbi vendimin e tyre. Njësia e VN-së mund të kërkojë informacione shtesë ose sqarime për t'u siguruar se politika/legjislacioni i propozuar plotëson një nga kriteret e përjashtimit.

Pas kësaj, Njësia e VN-së konfirmon përputhshmërinë me kriteret e përjashtimit. Nëse Njësia e VN-së në Kryeministri vendos se politika/legjislacioni i propozuar nga ministritë respektive nuk plotëson kriteret e përjashtimit, atëherë ministria e linjës propozuese duhet të kryejë VN për politikën e propozuar.

Hapat e procesit të zhvillimit të politikave në rastet kur një VN nevojitet

Nëse një VN kërkohet, ai duhet të shoqërojë gjithë procesin e zhvillimit të politikës. Ky proces përfshin të paktën 4 (katër) faza të rëndësishme:

1. Faza e zhvillimit;
2. Faza e konsultimit;

3. Faza finale;
4. Faza pas zbatimit/e shqyrtimit.

I njëjti format i raportit të VN-së (Aneksi 1) duhet të përdoret nga minsitritë e linjës për të plotësuar me informacionin e nevojshëm dhe për të kryer analizën gjatë hapave të ndryshëm të zhvillimit të VN-së.

Faza e zhvillimit

VN duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur gjatë procesit të zhvillimit të politikave. Kjo mund të bëhet, për shembull, kur shqyrtohen masat e politikës që do të përfshihen në një strategji apo në një dokument politikash kryesore të një ministrie. Për shembull, nëse një ministër identifikon një çështje apo problem të madh në një sektor apo fushë të caktuar që ka nevojë të trajtohet nëpërmjet një ndërhyrjeje të re të politikave, atëherë ekipi përgjegjës për këtë fushë në ministri do të përdorë metodologjinë dhe kuadrin e VN-së për të analizuar problemin.

Faza e konsultimit

Raporti i VN-së duhet të publikohet gjatë konsultimit publik së bashku me projektaktin dhe relacionin shpjegues. Kjo do t'u mundësojë të gjitha palëve të interesuara që të kuptojnë më mirë propozimin e politikave dhe se si do të ndikojnë ato. Kjo do të kontribuojë për një proces më të hapur dhe transparent të konsultimit publik.

Raporti i VN-së do të duhet të përditësohet gjatë procesit duke përdorur prova shtesë dhe të dhëna të marra gjatë konsultimit publik.

Faza finale

Faza finale është ajo kur paketa e nevojshme e dokumentacionit dorëzohet në Këshillin e Ministrave për miratimin përfundimtar. Analizat dhe dëshmitë e VN-së duhet të jenë të plota dhe të sakta në këtë fazë, duke përdorur dëshmitë dhe informacionin më të mirë të disponueshëm. *Raporti i VN-së duhet të dërgohet në Këshillin e Ministrave, së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme që shoqërojnë politikën/projektaktin e propozuar, sipas legjislacionit në fuqi.*

Nëse projektakti ndryshohet pas diskutimeve në Parlament, atëherë ministria përkatëse përgjegjëse duhet t'i shqyrtojë këto ndryshime dhe të përditësojë raportin e VN-së sipas nevojës.

Faza pas zbatimit/shqyrtimit

Pas përfundimit të planeve për monitorimin e zbatimit është gjithashtu e nevojshme që të vlerësohet opsioni që po zbatohet. Vlerësimi kryhet zakonisht pas fillimit të zbatimit. Qëllimi i vlerësimit është të çmojë nëse opsioni i zbatuar ka zgjidhur problemin e përcaktuar dhe ka arritur qëllimet e variantit të preferuar *pas një periudhe të caktuar kohe (jo më herët se 3-5 vite).*

Miratimi i vlerësimit të ndikimit

Përgjegjësia për zhvillimin e VN-së lidhet me ministrinë udhëheqëse, e cila ndërmerr nismën për projektaktin, rregullimin apo një masë politike të caktuar. Ministrat përgjegjës për një fushë të caktuar të politikave duhet të rishikojnë dhe të miratojnë raportin e VN-së të paktën dy herë – në fazën e

konsultimeve dhe në fazën finale, kur raporti i VN-së paraqitet në Këshillin e Ministrave për miratim përfundimtar.

Miratimi nga ministri duhet të konfirmojë se, në bazë të dëshmive dhe informacioneve më të mira të disponueshme, raportet përkatëse të VN-së japin një vlerësim të arsyeshëm të kostove, të përfitimeve dhe të risqeve të mundshme të ndërhyrjes kryesore të rekomanduar të politikave.

Procesi aktual i VN-së brenda ministrive duhet të udhëhiqet nga ekipet e politikave përkatëse dhe si të tillë ata kanë përgjegjësinë për të siguruar se VN ndjek procesin e saktë. Nëse politika apo projektakti mbulon fusha ose sektorë bazë të më shumë se një ministrie, atëherë mund të krijohet një grup ndërministror i politikave për të udhëhequr përgatitjen e VN-së. Në këtë rast, një nga ministrinë duhet të veprojë si ministri udhëheqës për koordinimin dhe drejtimin e punës për VN.

Në rastet kur ligjet kryesore apo dokumentet e strategjive përmbajnë më shumë se një propozim rekomandohet që për këto lloj projektligjesh apo dokumentesh të politikave të përgatitet më shumë se një raport VN. Çdo VN duhet të analizojë këto masa të politikës individuale veç e veç (opsionet, kostot dhe përfitimet etj.).

Nëse përgatitet më shumë se një VN për një ligj apo dokument strategjik kryesor, atëherë këto duhet të jenë të kombinuara dhe të raportohen përmes një raporti VN “gjithëpërfshirës”. Ky i fundit do të përmbledhë dhe do të paraqesë ndikimin e kombinuar të të gjitha propozimeve të përfshira në ligjin apo strategjinë kryesore.

Transparenca dhe publikimi i raporteve të vlerësimit të ndikimit

Transparenca është parim themelor i rregullimit/politikëbërjes së mirë dhe VN ndihmon në arritjen e këtij objekti. Për këtë arsye, është e domosdoshme që procesi i VN-së të shpjegojë qartë se është ndjekur procesi i rregullt i konsultimit publik, kur janë marrë vendimet dhe se rezultatet e këtij procesi janë publikuar.

Raportet e VN-së të mëposhtme duhet të publikohen:

- Gjatë fazës së konsultimit publik. Raporti i VN-së duhet të publikohet gjatë fazës së konsultimit së bashku me projektaktin/politikën, për të cilën bëhet konsultimi. Raporti i VN-së, gjithashtu, mund të publikohet edhe pas kësaj faze në mënyrë që të përditësohet si rezultat i konsultimeve (kjo në diskrecionin e ministrisë përkatëse).
- Pas fazës finale. Kur projektakti është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe është dorëzuar në Parlament.

VN do të duhet të publikohet nga ministria përkatëse së bashku me projektaktin dhe relacionin shpjegues në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, si dhe në faqe të tjera të nevojshme (faqet zyrtare të ministrive).

Përmbledhje e hapave kryesorë proceduralë në procesin e VN-së

Tabela më poshtë paraqet hapat kryesorë të procesit të zhvillimit të vlerësimit të ndikimit:

Hapat kryesorë proceduralë në procesin e zhvillimit të VN-së	
1.	Njësitë përgjegjëse për hartimin e politikave/legjislacionit në çdo ministri iniciojnë propozime të reja. Ekipi i politikave kryen vlerësimin fillestar për të vendosur nëse është i nevojshëm apo jo VN, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Metodologji. Përgatitja e fazës së zhvillimit të VN-së inicohet për ato politika që janë objekt i VN-së dhe ky vlerësim paraprak është dokument i brendshëm i ministrisë.
2.	Ministri nxjerr urdhër për miratimin e propozimeve të reja të politikave, konfirmon objektivat e politikës për përfshirje në programin analitik të projektakteve. Ministri ngre një grup ministror pune për të udhëhequr zyrtarisht zhvillimin e VN-së dhe hartimin e legjislacionit. Çdo propozim i ri i politikës/legjislacionit të iniciuar nga ministria dhe që plotëson kriteret e VN-së duhet të ketë një raport të përgatitur për VN. Njësitë rregulatore (të VN) në çdo ministri duhet të jenë pjesë e grupit të punës bashkë me ekipet e politikave përkatëse.
3.	Ekipi i VN analizon masat politike dhe ndikimin e tyre duke përdorur modelin tip të VN-së që është dhënë në aneksin 1 dhe duke u bazuar në këtë Metodologji.
4.	Njësia e VN-së në Kryeministri do të kontrollojë listën e të gjitha propozimeve të reja që janë paraqitur nga ministrinë për t'u përfshirë në programin analitik të projektakteve për të siguruar se procesi i VN-së

	dhe kërkesat janë ndjekur dhe se është përgatitur raporti i VN.
5.	Masat përfshihen/konfirmohen në programin analitik të projektakteve. Ministrinë vazhdojnë të punojnë për VN-në për t'u përgatitur për fazën e konsultimit.
6.	Konsultimet ndërministrrore. Draft i raportit të VN-së i fazës së konsultimit i përgatitur ndahet me ministrinë dhe aktorët e tjerë për konsultim; provat dhe analizat e paraqitura në raportin e VN-së gjatë fazës së konsultimeve diskutohen me ministri të ndryshme për të siguruar se vlerësimi i tyre i brendshëm i një propozimi specifik (p.sh., ndikimi fiskal, ndikimi mjedisor, social, përputhshmëria me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim etj.) është në përputhje me analizën dhe konkluzionet e paraqitura në raportin e VN-së.
7.	Ekipi i VN-së në ministri finalizon raportin e VN-së të fazës së konsultimit dhe e përgatit për konsultim publik. (Ministri përkatës aprovon raportin e VN-së të fazës së konsultimit së bashku me relacionin shpjegues dhe projektaktin).
8.	Realizohet konsultimi publik. <i>Raporti i VN-së i fazës së konsultimit</i> duhet të publikohet së bashku me dokumentin e politikave apo projektaktin.
9.	Rezultati i konsultimeve publike, provat shtesë dhe të dhënat e mbledhura gjatë procesit të konsultimit publik duhet të përdoren për të përditësuar analizën dhe për të forcuar dëshmitë e bazuara në VN.

10.	Ministritë përgatisin paketën me të gjitha dokumentet e nevojshme që kërkohen për miratimin e politikës/projektaktit në Këshillin e Ministrave. Njësia e VN-së në Kryeministri mund të kundërshtojë analizat dhe provat dhe/ose të kërkojë informacione apo sqarime shtesë për të siguruar se cilësia e VN-së plotëson standardet e përcaktuara nga kjo Metodologji. Më pas përgatitet VN e përditësuar, aprovohet nga ministri përkatës për t'u dorëzuar në Këshillin e Ministrave për miratim përfundimtar.
11.	VN i fazës finale dorëzohet në Këshillin e Ministrave së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës. Njësia e VN-së në Kryeministri shqyrton cilësinë e analizave të raportit të VN.
12.	Pas miratimit të Këshillit të Ministrave, raporti i VN-së i fazës finale dorëzohet në Parlament, së bashku me të gjitha dokumentet e tjera që shoqërojnë projektaktin.
13.	Nëse janë bërë ndryshime në hartimin e politikave apo në organizimet e implementimit ose të zbatimit gjatë procesit të miratimit në Parlament, atëherë VN do të duhet të përditësohet për t'i reflektuar këto ndryshime. Përgjegjësia për të bërë këto përditësime në raportin e VN-së i takon ministrisë udhëheqëse përkatëse.
14.	Fillon zbatimi i politikës. Informacioni dhe të dhënat e VN-së përdoren gjatë monitorimit.
15.	Shqyrtohet VN për fazën e rishikimit pas zbatimit (jo më herët se 3-5 vjet).

Koha që kërkohet për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit

Koha faktike e nevojshme për përfundimin e një VN-je varet nga lloji dhe natyra e politikës apo projektaktit që propozohet. Përgatitja e hershme dhe planifikimi i politikave brenda ministrive është e rëndësishme. Kohëzgjatja e procesit përgatitor të VN-së pasqyron në masë të madhe kohën e nevojshme për përgatitjen dhe miratimin e një politike të re apo projektakti. Megjithatë, procesi VN nuk merr fund pasi të miratohet politika apo projektakti. Një afat indikativ jepet më poshtë:


- Analiza fillestare për të përgatitur fazën e zhvillimit (identifikimi i problemit, arsyetimi i ndërhyrjes dhe përcaktimi i rasteve të përjashtimit) – nga 3 deri në 4 javë;
- Përgatitja e fazës së konsultimit publik të VN-së, pas krijimit të grupit të punës në çdo ministri mbi projektaktin që do të propozohet – nga 6 deri në 12 javë;
- Përditësimi pas konsultimit publik dhe përgatitja e draftit final të projektaktit për miratim nga Këshilli i Ministrave – nga 8 deri në 12 javë.

Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve

Procesi i VN-së do të prekë të gjitha institucionet qeveritare të përfshira në procesin e hartimit të politikave. Si i tillë, procesi i përgatitjes dhe zbatimit të VN-së do të koordinohet nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore (Njësia e VN-së) e ngritur në Kryeministri posaçërisht për këtë qëllim.

Njësia e VN-së në Kryeministri do të sigurojë mbikëqyrjen e duhur dhe funksionin mbështetës gjatë zbatimit të VN-së nga ana e ministrive proponente të projekteve që do të shoqërohen me VN.

Aktorët kryesorë të procesit të VN-së



Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri

Ky departament luan një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të programit legjislativ të qeverisë. Departamenti do të vazhdojë kryerjen e shqyrtimit dhe të kontrollit përfundimtar të cilësisë të të gjitha projektakteve (dhe dokumenteve shoqëruese **përfshirë VN**) para se ato të paraqiten në Këshillin e Ministrave për miratim.

VN do të integrohet në këtë proces. Prandaj, departamenti do të përdorë provat dhe analizat e paraqitura në raportin e VN-së për të kryer funksionin e tij bazë. Kjo do të lidhet kryesisht me masat legjislative.

Njësia e VN, pjesë e këtij departamenti, do të kryejë funksionet e mëposhtme:

- Të ofrojë udhëzime të rregullta dhe mbështetje për të gjitha ministrinë e linjës gjatë të gjitha fazave të procesit të zhvillimit të VN-së, si dhe:
 - Të sigurojë se të gjitha propozimet ligjore që plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara në këtë Metodologji, të kalojnë në procesin e VN-së;
 - Të ofrojë sqarime për çështje të ndryshme metodologjike në këtë kuadër.
 - Të udhëzojë se si plotësohen modelet tip të VN-së.
 - Të rishikojë dhe të përmirësojë në vazhdimësi Metodologjinë e VN-së.
- Të kontrollojë dhe të konfirmojë listën e të gjitha propozimeve të reja të ministrive të linjës për t'iu nënshtruar procesit të VN-së.
- Të analizojë raportet e VN-së të përgatitura nga ministrinë e linjës.
- Të analizojë përfitimet, kostot dhe risqet e një politike publike të propozuar dhe mundësitë më optimale në dispozicion për zbatim.
- Të shqyrtojë rezultatin e procesit fillestar të kontrollit për të siguruar se të gjitha politikat legjitime i nënshtrohen VN-së.

- Të shqyrtojë cilësinë e VN=së, si dhe të kërkojë informacion dhe analizë shtesë në rast të mangësive të gjetura në VN.
- Të ushtrojë funksionin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së nevojshme për të siguruar që procesi dhe niveli i analizës në VN të përgatitur nga ministritë e linjës përmbush standardet e kërkuara.

Ministria përgjegjëse për çështjet e integritimit evropian dhe punët e jashtme

Kjo ministri, në kuadër të procesit të harmonizimit të legjislacionit me atë të BE-së, do të mundësojë udhëzime në lidhje me kërkesat e procesit të harmonizimit me legjislacionin e BE-së gjatë procesit të zhvillimit të VN-së.

Ministria do të përdorë raportin e VN-së për të kuptuar plotësisht ndikimet e mundshme dhe pasojat e politikës së propozuar në procesin e integritimit në BE. Raporti i VN-së duhet gjithashtu të tregojë nëse një projektakt i veçantë është i përfshirë në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE).

Ministria përgjegjëse për çështjet ekonomike dhe financiare

Kjo ministri ka një rol tejet të rëndësishëm në procesin e përgjithshëm të VN-së dhe në garantimin e një analize cilësore për të mbështetur të gjitha propozimet e reja politike. Ky proces do të ndihmojë këtë ministri për të nxitur disiplinën fiskale dhe për të siguruar që ministritë të kryejnë analizat e nevojshme për të mbështetur iniciativat e reja të politikave që ka të ngjarë të kenë ndikim fiskal. Kjo do të ndihmojë dhe do të kontribuojë në

planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit dhe të planit buxhetor afatmesëm të përgjithshëm.

Çdo kosto shtesë, përfshirë ato në buxhetin e shtetit që rrjedhin nga propozimi i ri i politikës duhet të vlerësohen dhe të raportohen si të tilla në raportin e VN-së. Ky informacion do të përdoret nga kjo ministri për të siguruar një planifikim fiskal të qëndrueshëm.

Kjo gjithashtu do të ndihmojë këtë ministri për të krijuar një proces sistematik të analizimit të ndikimeve në biznes. Ministria mund të përdorë mjetin e VN-së për të krijuar dhe zbatuar një thjeshtësim të gjerë dhe programim më të mirë të rregullimit për të reduktuar barrën rregullatore dhe kostot ndaj biznesit, si dhe për të përmirësuar më tej mjedisin e biznesit në Shqipëri. Kjo është e rëndësishme veçanërisht për ndikimet në NVM.

Ministria e Drejtësisë

Kjo ministri do të përdorë raportin e VN-së për të kuptuar objektivat dhe arsyetimin për të gjitha projektaktet e propozuara, për të cilat kërkohet mendim zyrtar.

Ministria përgjegjëse për çështjet e turizmit dhe mjedisit

Kjo ministri është përgjegjëse për kryerjen e VN në mjedis të politikave dhe projektakteve. Provat dhe analiza e paraqitur në raportin e VN-së në lidhje me ndikimin mjedisor do të vlerësohen nga ekspertët e kësaj ministrie për të siguruar se është realizuar plotësisht vlerësimi i ndikimit në mjedis. Informacioni dhe mendimi i dhënë nga kjo ministri duhet të konsiderohet nga ministria udhëheqëse e politikës së propozuar kur të finalizohet raporti i VN-së.

Strutura përgjegjëse për konsultimin publik

Procesi i VN mund të ndihmojë në forcimin e procesit të konsultimit publik nëpër ministri. Struktura përgjegjëse për konsultimin publik mund ta përdorë këtë informacion dhe statistikat në raportin e VN-së me qëllim monitorimin dhe raportimin mbi praktikën e konsultimit publik.

Rrjeti i njësive të VN në ministrinë e linjës

Njësitë e VN-së në çdo ministri do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Metodologjisë së VN-së nëpër ministri. Këto njësi së bashku do të krijojnë rrjetin e VN-së, i cili do të udhëhiqet dhe do të koordinohet nga Njësia e VN-së në Kryeministri. Këto njësi do të koordinojnë punën dhe do të ofrojnë asistencë brenda ministrisë për plotësimin e raportit të VN-së dhe për ta përcjellë atë në versionin final zyrtarisht tek Njësia e VN së Kryeministrisë.

Raporti final i VN përcillet tek Njësia e VN-së në Kryeministri për shqyrtim dhe miratim dy herë gjatë procesit të zhvillimit të politikës/legjislacionit: Së pari, pas hartimit dhe miratimit të raportit të VN-së së brendshmi në ministrinë përkatëse sipas fushës specifike të politikës që propozohet të ndërmerret, si dhe në fazën finale të hartimit të projektaktit bashkë me dokumentacionin shoqërues, i cili përcillet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave.

Domosdoshmëria e kryerjes së vlerësimit të ndikimit

Në fazën më të hershme të mundshme

VN duhet të fillojë në fazën më të hershme të mundshme të procesit të zhvillimit të politikave/legjislacionit, pasi ai është i projektuar për të ndihmuar vendimmarrësit të vendosin nëse duhet ndërmarrë një politikë/projektakt/rregullim i caktuar apo jo. Kjo duhet të përfshijë të gjitha propozimet e politikave dhe idetë fillestare në lidhje me ndërhyrjen e qeverisë që është vlerësuar për t'u bërë në strategjitë e ndryshme sektoriale, dokumentet apo në programet e politikave. Ky vlerësim paraprak mund të jetë dokument i brendshëm i punës në ministri.

Për të analizuar propozimet e politikave

VN duhet të përdoret për të analizuar propozimet e politikave/legjislacionit, të cilat janë të përfshira në strategjitë, dokumentet dhe programet kryesore të qeverisë. Metodologjia do t'i ndihmojë ministritë e linjës që të kryejnë vlerësimin sistematik të të gjitha ndikimeve të politikave në një fazë të hershme, për të treguar se përfitimet e pritshme kumulative të strategjive apo dokumenteve politike do të jenë më të mëdha se kostot kumulative në total të tyre.

Për të përmirësuar cilësinë e ligjeve dhe rregullimeve të reja

Ligjet janë të rëndësishme për jetësimin e shumë politikave dhe programeve, por është pranuar gjithashtu gjerësisht se

projektimi i dobët dhe jo i menduar mirë i politikave mund të krijojë kosto dhe barrë të panevojshme për të gjithë shoqërinë.

VN nuk është një dokument që hartohet vetëm një herë, por ai duhet të shqyrtohet dhe të përditësohet në mënyrë periodike.

Analiza dhe dëshmitë e VN-së përmblihen dhe paraqiten në raportin e VN-së, i cili nuk është një dokument "që hartohet vetëm një herë", por ai duhet të shqyrtohet dhe të përditësohet rregullisht gjatë procesit të zhvillimit të politikave. Raporti i VN-së është një dokument i pavarur që do të thotë se lexuesit e dokumentit duhet të kuptojnë plotësisht të gjitha hollësitë e rëndësishme në lidhje me politikën dhe ndikimin e saj dhe pasojat e propozimit për marrjen e një vendimi të argumentuar.

Për të siguruar një nivel proporcional detajesh dhe analizash

Gjatë gjithë procesit të VN-së është e rëndësishme që të sigurohet një nivel proporcional detajesh dhe analizash. Sa më i kushtueshëm, i dobishëm, me risk ose i diskutueshëm të jetë ndryshimi i propozuar, aq më e rëndësishme është që të sigurohen dëshmitë mbështetëse përse ai ndryshim duhet të bëhet. Sa më i rëndësishëm të jetë vendimi, aq më e rëndësishme është që ai të merret i drejtë, dhe për këtë arsye përpjekjet më të mëdha duhet të kanalizohen në këto raste.

Për të identifikuar ndikimin e shpërpjesëtuar ndaj grupeve të caktuara

Kjo duhet të përfshijë situatat kur ndërhyrjet e politikave ndikojnë në mënyrë të shpërpjesëtuar ndaj grupeve të veçanta në shoqëri, për shembull të moshuarit, ata që përdorin një shërbim të caktuar apo bizneset e vogla. VN nuk është thjesht një përmbledhje e ndikimit ndaj të gjitha grupeve në shoqëri, edhe

pse kjo është pjesë e saj, por identifikon gjithashtu se ku kanë gjasa të përfitojnë ose të vuajnë më shumë disa grupe si rezultat i kësaj. Mund të kërkohen veprime për të zbutur këto efekte, të cilat duhet të argumentohen nga rëndësitë e ndryshimit, procesi i konsultimit dhe sa e lehtë është për të zbutur efektet.

Për të marrë në konsideratë se në cilën fazë është i disponueshëm informacioni

Mund të mos jetë e mundur për të siguruar atë sasi informacioni që do të ishte ideale, veçanërisht në fillim të procesit. Kjo mund të ndodhë për shkak se informacioni nuk është i disponueshëm, ndoshta për shkak se koha është e kufizuar. Në raste të tilla, mund të jetë e përshtatshme që të sigurohet informacion më vonë, si psh., në fazën përfundimtare të VN-së. Kjo krijon mundësinë për të pasur më shumë kohë për të përfunduar modelimin analitik ose për të lejuar mbledhjen e të dhënave, si pjesë e procesit të konsultimit për të qenë në gjendje që të vlerësohen efektet. Teksa bëhet përparim përmes fazave të VN-së dhe të zhvillimit të politikave, sasia e informacionit të përfshirë dhe niveli i detajeve dhe i analizave rritet.

Për të identifikuar çdo opsion që bëhet i përealizueshëm

Mund të ndodhë që disa nga alternativat e mundshme për zgjidhjen e problemit të eliminohen përgjatë procesit me kushtin që ky eliminim nga shqyrtimi të jetë i bazuar në provat që janë në dispozicion. Për shembull, nga konsultimet mund të konstatohet se një prej alternativave është jofunksionale, dhe nuk mund të zbatohet.

Vlerësimi i ndikimit për projektligjet që transpozojnë acquis të BE-së

Gjatë përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së apo vendosjen e rregullave të reja të brendshme për të zbatuar rregulloret e BE-së duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të siguruar që këto ligje dhe rregullore të minimizojnë koston dhe barrën shtesë mbi ekonominë. *VN-së do t'i nënshtrohen të gjitha projektligjet që përbëjnë transpozim të pjesshëm apo të plotë të acquis.* Procesi i VN-së duhet të ndihmojë ministrinë përgjegjëse për çështjet e integritit evropian dhe ministrinë e linjës që të analizojnë sistematikisht kostot dhe përfitimet e ndryshimeve të ndryshme ligjore dhe opsionet që kërkohen gjatë procesit të harmonizimit.

Tabelat e përputhshmërisë që janë përgatitur për transpozimin e acquis të BE-së në legjislacionin kombëtar mund të përdoren dhe të përfshihen në raportin e VN-së për të ndihmuar në strukturën e analizës së ndikimit të masave të ndryshme. VN për çdo masë të përfshirë në kuadër të procesit të përafrimit ligjor të BE-së duhet të përfshijë sa më poshtë vijon:

- Vlerësimet e ndikimeve të harmonizimit ligjor;
- Lejimin e krahasimit të legjislacionit ekzistues kombëtar me legjislacionin evropian dhe ndikimin e tyre.

Qëllimi i kësaj analize dhe krahasimi është që të konstatojë ndryshimet ligjore dhe institucionale që duhet të trajtohen. Këto ndryshime duhet të identifikohen në kuptimin e kërkesave, masave, mekanizmave dhe procedurave të zbatimit dhe të kërkesave organizative të nevojshme për zbatimin. Duhet të

identifikohen dhe të maten vetëm dallimet në mes të legjislacionit ekzistues dhe të BE-së. Kjo duhet të konsiderohet si pjesë e një analize të rregullt e opsioneve, si pjesë e procesit të zhvillimit të vlerësimit të ndikimit.

Ka disa çështje të tjera që duhet të merren parasysh për ligjet apo rregullimet që bëhen si pjesë e harmonizimit të legjislacionit me BE-në, të cilat paraqiten më poshtë:

Nuk ekziston opsioni: “status quo”

Në shumicën e rasteve nuk ekziston opsioni i “status quo-së” pasi ekziston detyrimi (angazhimi) për harmonizimin. Megjithatë, duhet të ketë analiza të opsioneve të ndryshme (duke përfshirë kohën dhe zbatimin) gjë e cila lejohet në legjislacionin e BE-së për të minimizuar koston shtesë.

Shqyrtimi me kujdes i të gjitha opsioneve në VN

Këto opsione dhe të gjitha alternativat ndaj rregullimit duhet të shqyrtohen me kujdes në VN dhe të ndahen me të gjitha palët e interesuara si: biznesi, organizatat e shoqërisë civile etj.

Gjatë përgatitjes së VN-së për projektligjet që transpozojnë direktiva të BE-së duhet të merren parasysh të gjitha ndikimet në ekonomi, të tilla si: në tregti, konkurrencë, turizëm, investime etj. Për qëllime të harmonizimit fokusi kryesor është në sa më poshtë vijon:

- Të dhënat statistikore specifike të Evropës për ndikimet në sektorë të veçantë ekonomikë.
- Palët e interesuara që preken nga tregtia me BE-në.

- Detyrimet e *acquis* që mund të përfshijnë palët e interesuara lokale që bëjnë tregti apo që nuk bashkëveprojmë me BE-në, por që ende preken direkt apo indirekt nga rregullimi.

Grupimi i rregulloreve të BE-së në mënyrë logjike

Një pjesë e legjislacionit të BE-së mbulon më shumë se një fushë kryesore të një politike të caktuar. Prandaj, harmonizimi i legjislacionit të BE-së mund të kërkojë më shumë se një ligj apo rregullim në nivel kombëtar. Rregulloret evropiane duhet të grupohen në rregullore të strukturuar dhe të ndërvarura në mënyrë logjike për të ndihmuar analizimin e ndikimeve, p.sh., për rregulloret e menaxhimit të mbetjeve ose rregulloret e transportit rrugor, nëse është e mundur, VN duhet të identifikojë ndikimet e rregullimit të veçantë, por nëse kjo nuk është e mundur, atëherë të vlerësojë ndikimet e të gjitha rregulloreve të lidhura/të ndërvarura. Për të kombinuar dhe paraqitur rezultatet e më shumë se një politike të mbuluar nga një rregullore e BE-së mund të përdoret një VN gjithëpërfshirëse.

Shqyrtimi i vlerësimeve të ndikimit nga vendet e tjera anëtare

Në kuadër të harmonizimit të legjislacionit me *acquis* e BE-së duhet të shikohet mundësia e shqyrtimit të VN-së të përgatitur nga vendet e tjera anëtare; të identifikohen ato me ndikime të ngjashme dhe të shqyrtohet mundësia e përdorimit të analizës për Shqipërinë si pikë referimi. Përdorimi i përvojës së harmonizimit të vendeve që janë anëtarësuar më parë në BE mund të jetë e dobishme dhe mund të identifikojë ndikimet e paidentifikuara më parë që janë të rëndësishme për procesin e VN-së.

VN ekzistuese të BE-së janë një burim i dobishëm dëshmish dhe të dhënash


Shumica e direktivave dhe e rregulloreve të BE-së kanë kryer tashmë VN në nivel të Komisionit Evropian. Këto VN të BE-së janë burim i dobishëm informacioni dhe dëshmish, të cilat duhet të merren parasysh dhe të përdoren gjatë përgatitjes së VN-së.

Identifikimi i kërkesave të zbatimit

Identifikimi në VN se si mund të zbatohen këto ndryshime për shkak të harmonizimit dhe identifikimi se kush duhet të zbatojë ndryshimet, p.sh. ministritë e linjës apo institucione të tjera të tilla: si pushteti vendor.


Pjesa II: Përgatitja e VN-së

Kjo pjesë e Metodologjisë parashikon hapat e detajuar se si përgatitet vlerësimi i ndikimit. Ajo përmban disa elemente që ndihmojnë në strukturimin dhe realizimin e procesit analitik dhe konsultimit me palët e interesuara duke dhënë sqarime praktike, lista kontrolli dhe këshilla se si të zhvillohen analizat për një vlerësim ndikimi të qenësishëm.



Mbledhja e të dhënave dhe e dëshmimeve të besueshme për analiza dhe përgatitja e dokumentacionit për përfundimtar të ministrave.

Hapi I: Identifikimi i problemit dhe arsyet e ndërhyrjes



Hapi i parë në procesin e VN-së është identifikimi dhe analizimi i problemit të politikave. Ministrat e linjës, të cilat hartojnë propozimin e politikave që do të përfshihen në një dokument strategjie/program sektori ose që punojnë për hartimin e një projektakti duhet të jenë në gjendje që të identifikojnë dhe të analizojnë problemin aktual të politikës që propozimi synon të trajtojë.

Ato duhet të përqendrohen në atë se cili është problemi dhe të marrin parasysh çështjet në vijim:

- Cili është problemi – shpjegohet në mënyrë të përmbledhur se cili është problemi.
- Identifikimi i shtrirjes së plotë të problemit.
- Cilat janë shkaqet?
- Identifikimi i grupeve të prekura nga ky problem - biznesi/shoqëria civile/qytetarët.
- Vlerësimi nëse problemi mund të trajtohet apo jo me një ndryshim të politikës.
- Renditja e çështjeve/legjislacionit të lidhur me qeverinë.
- Renditja e punës ekzistuese tashmë të kryer.

Ministritë e linjës duhet që të analizojnë situatën dhe të sigurojnë informacion të plotë dhe gjithëpërfshirës për këtë problem. Sa më shumë që të kuptojnë se cili është problemi aktual, aq më shumë do të jenë në gjendje të hartojnë politika/projektakte ku të trajtojnë e të zgjidhin problemin në planin afatmesëm ose afatgjatë. Identifikimi i problemit duhet të ndihmojë për argumentimin e ndërhyrjes së qeverisë.

Pse qeveria ndërhyt me ligje dhe masa të tjera rregullatore?

Qeveria ndërhyt në tregje nëpërmjet ligjeve dhe masave të tjera rregullatore në radhë të parë për të adresuar çështjet dhe problemet e krijuara nga të ashtuquajturat “dështimet e tregut” dhe/ose për të arritur objektiva të caktuar të barazisë ose të mirëqenies sociale (p.sh., për të siguruar barazi për të gjitha segmentet e popullsisë ose rajonet e ekonomisë ose për të çuar

përpara përfshirjen sociale). Dështimi i tregut është një situatë kur tregu në vetvete nuk është në gjendje të japë rezultate të efektshme për shoqërinë. Kjo ndodh kryesisht për shkak të faktorëve të jashtëm, të mirave publike, informacionit asimetrik apo të paplotë. Në të gjitha këto raste qeveria përpiket të ndërhyjë me anë të rregullimeve apo ligjeve për të minimizuar ndikimin negativ dhe pasojat e dështimit të tregut. *Tabela më poshtë përfshin disa detaje dhe shembuj të dështimit të tregut:*

	Problemi	Rezultati	Shembuj	Ndërhyrja e Qeverisë
Mallra publike	Mallrat publike janë ato mallra, të cilat janë jozëvendësuesë dhe joplotësuesë.	Mallrat kanë ofertë të ulët në treg. Ata që refuzojnë të paguajnë nuk mund të përjashtohen nga konsumi.	Mbrojtja, ndriçuesit e rrugëve, faret	Masat e marra nga qeveria
Faktorët e jashtëm	Kur një veprimtari ka një ndikim (pozitiv apo negativ) mbi dikë tjetër jo drejtpërsëdrejti të përfshirë në këtë veprimtari.	Duke qenë se këto ndikime nuk janë të reflektuar në çmim, blerësi ose konsumatori nuk duhet ta llogarisë këtë ndikim në momentin që vendos sa do ta blejë ose sa do të konsumojë një mall. Kjo çon në mbi/nën prodhim/konsumim të këtyre mallrave.	Ndotja nga duhani, vaksinimet, arsimi	Taksat, të drejtat e pronësisë, subvencionet, incentivat

Informacion jo perfekt	Njëra palë ka një informacion dhe kjo përbën avantazh mbi një palë tjetër.	Mungesa e ekuilibrit të informacionit mund të jetë kaq e theksuar saqë tregu mund të mbyllet. Nëse blerësi nuk është i sigurt për cilësinë e mallit që kërkon të blejë, ai mund të vendosë të mos e blejë atë. Nëse shitësi nuk është i sigurt se çmimi është i duhuri, ai mund të mos e shesë mallin.	Siguracionet, makinat e përdorura	Masat e qeverisë për ofrim të informacionit, duke dhënë informacion të drejtpërdrejtë, rregullimi.
Fuqia e tregut	Nëse tregjet nuk janë mjaftueshëm konkurruese, bizneset individuale kanë fuqinë të vendosin çmime, të cilat janë shumë të larta.	Mallrat ofrohen me çmim më të lartë dhe sasi të kufizuar në krahasim me çfarë mund të ofrohej në një mjedis konkurrues perfekt.	Monopolet, Microsoft	Politikat e konkurrencës, industritë e rregulluara, shtetëzimi

Megjithatë, shumë shpesh vetë ndërhyrja e qeverisë nuk arrin të realizojë qëllimet dhe objektivat e parashikuar. Kjo situatë quhet “dështimi rregullator”. Është pranuar gjerësisht se vetë dështimet rregullatore krijojnë kosto dhe barrë të mëdhe mbi ekonominë.

Për këtë arsye, ligjet dhe rregullimet e reja duhet të shqyrtohen dhe të analizohen me kujdes për të justifikuar çdo ndërhyrje të qeverisë dhe për të siguruar se nuk ka tjetër alternativë jorregullatore që mund të realizojë objektivat e politikave. Kur

ndërmerren nisma rregullatore, ato duhet të hartohen, të përgatiten dhe të prezantohen në mënyrë që ato të ndjekin parimet më të mira të rregullimit dhe të minimizojnë çdo kosto dhe barrë shtesë.

Është gjithashtu e rëndësishme që ministrinë e linjës që janë përgjegjëse për politikën që synojnë të propozojnë, të vlerësojnë kohën e realizimit të ndërhyrjes. Kjo duhet të shqyrtohet brenda kontekstit më të gjerë dhe prioriteteve që ekzistojnë brenda qeverisë për të siguruar koherencë me objektivat e nivelit të lartë të qeverisë për fusha të veçanta.

- Sigurimi i arsytimit përse ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme.
- Shpjegime përse qeveria është duke planifikuar për të ndërhyrë dhe pse kjo është e nevojshme.
- Shpjegime se çfarë shpreson të trajtojë qeveria përmes kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikimi i shkallës së ndërhyrjes së qeverisë që është e nevojshme për të trajtuar problemin.
- Identifikimi i çdo alternative ndaj ndërhyrjes së qeverisë.
- Shpjegimi se si kjo ndërhyrje e veçantë mbështet objektivat e qeverisë të përcaktuar në dokumente dhe strategji të ndryshme (p.sh., Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim apo të tjera).

Në tabelën më poshtë jepet një shembull hipotetik për të treguar si të përshkruajmë problemin aktual dhe arsyen e ndërhyrjes:

Politikat për të vendosur raportimin e detyrueshëm të emetimit të dioksidit të karbonit në sektorin e transportit.

Sektori i transportit është një burim i rëndësishëm për emetimin e gazrave të serrës (GHG). Në vitin 2016, emetimi i këtyre gazrave nga sektori i transportit përfaqëson 20% të totalit të emetimit në Shqipëri. Gjatë periudhës 2000-2016, emetimi në tërësi i këtyre gazrave që vijnë nga transporti është rritur me 30%. Megjithatë, emetimi i dioksidit të transportit nga sektori i transportit deri më sot nuk është monitoruar dhe raportuar në mënyrë të standardizuar dhe të krahasuar. Mungesa e të dhënave të besueshme e pengon qeverinë shqiptare nga përcaktimi i politikave të përshtatshme për të promovuar reduktimin e emetimit. Gjithashtu, ajo nuk e lejon qeverinë të raportojë se si Shqipëria po kontribuon në arritjen e objektivave sipas BE-së për këto gazra.

Ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për të reduktuar mundësitë e dështimit. Në mungesë të rregullimeve për raportimin, emetuesit nuk do të raportojnë mbi emetimet vullnetare të dioksidit të karbonit. Ndërhyrja e qeverisë është gjithashtu e justifikuar nga dështimet e tregut si psh. nga faktorët e jashtëm negativë dhe klima/mjedisi si një e mirë publike globale.

Faktorët e jashtëm negativë:

Rritja e përqendrimit të gazit të serrave në atmosferë imponon kosto të shoqëria. Megjithatë, kostoja e plotë e këtyre emetimeve nuk ka lindur nga emetuesi, duke nënkuptuar në këtë mënyrë se bizneset nuk llogarisin kostot e emetimit kur bëjnë zgjedhjen e produktit të tyre.

Pa ndërhyrjen e qeverisë, incentivat ekonomike për bizneset që të ndryshojnë sjelljen e tyre janë të vogla dhe emetimet e gazrave të serrave nuk mund të reduktohen në nivele që të jenë në përputhje me shmangien e pasojave serioze nga ndryshimet klimaterike.

Klima/mjedisi si e mirë publike globale


Ata që nuk paguajnë për klimën/mjedisin si e mirë publike globale nuk mund të përjashtohen nga të pasurit përfitime dhe përfitimet e një personi ndaj kushteve klimatike nuk zvogëlojnë aftësinë e të tjerëve për të përfituar.

Këto karakteristika jozëvendësuese dhe joplotësuese nënkuptojnë se pa ndërhyrjen e qeverisë, tregu nuk mund të ofrojë mbrojtjen e mjaftueshme ndaj kushteve klimatike.

Anasjelltas, bizneset kanë incentivat për ta adresuar vetë çështjen në rrjedhën e lirë të tregut, pasi ata nuk mund të përjashtohen nga përfitimet. Në këtë rast, tregjet për mallra dhe shërbime që kanë një ndikim mbi mjedisin (përfshirë transportin) nuk reflektojnë pasojat e konsumatorëve të ndryshëm dhe zgjedhjeve të investimeve për klimën/mjedisin.

Kjo politikë mbështet objektivat e qeverisë të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Ndryshimeve Klimaterike dhe është në përputhje të pjesshme me direktivën 2018/12/EC të BE-së.

Hapi 2: Objektivat



Si të vendosen objektivat

Hapi i dytë i procesit të VN-së është vendosja e objektivave të politikave. Vendosja e objektivave ofron një kurs të qartë veprimi dhe përcakton rezultatet e dëshiruara që duhet të arrihen. Objektivat paraqesin karakteristikat e fazës së dëshiruar në afatet kohore të planifikuara dhe, për këtë arsye, duhet të jenë të qarta

dhe realiste si dhe, në përputhje me burimet në dispozicion dhe kufizimet kohore.

Është e rëndësishme që ministrinë e linjës, të cilat përcaktojnë objektivat sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, duhet të konsultohen me të gjitha dokumentet e rëndësishme, strategjitë e politikat e qeverisë për të qenë në harmoni dhe të lidhen me to. Kjo duhet të përfshijë të gjithë objektivat dhe qëllimet e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), në programin dhe planet e qeverisë, si dhe në dokumentet e materialet strategjike.

Ato gjithashtu mund të përcaktohen nga pikëpamja e periudhave kohore afatmesme dhe afatgjata të lidhura me angazhimet, prioritetet dhe agjendat e njohura të qeverisë, të BE-së dhe ato ndërkombëtare. Objektivat duhet të formulohen në mënyrë që të përmbushin kërkesat "SMART".

Objektivat SMART duhet të jenë:

- Specifikë - objektivat duhet të jenë të qartë dhe konkretë aq sa të mos jenë të hapur për interpretim. Ata duhet të kuptohen nga të gjithë në të njëjtën mënyrë.
- Të matshëm - objektivat duhet të përcaktojnë një gjendje të dëshiruar në të ardhmen në tema të matshme, në mënyrë që të jetë e mundur që të verifikohet nëse objektivi është arritur apo jo.
- Të arritshëm - ata që janë përgjegjës për realizimin e objektivave, duhet të jenë në gjendje për t'i arritur ato, edhe në qoftë se objektivi i vendosur është sfidues.


- Realistë - objektivat duhet të jenë realistë për të siguruar që ata janë të rëndësishëm.
- Në kohë - objektivat dhe synimet duhet të jenë të vendosur brenda afateve kohore të miratuara.

Në tabelën më poshtë jepet një shembull hipotetik për të treguar si të përshkruajmë objektivat e politikës/rregullimit:

Politika për të vendosur raportimin e detyrueshëm të emetimit të dioksidit të karbonit në sektorin e transportit

- *Objektivi në tërësi i politikës për të vendosur raportimin e detyrueshëm të emetimit të dioksidit të karbonit në sektorin e transportit konsiston në krijimin e një mekanizmi për të mbledhur të dhëna mbi emetimin e dioksidit të karbonit në sektorin e transportit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për politikën që promovojnë uljen e emetimit.*
- *Kjo politikë gjithashtu do të kontribuojë në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë për të raportuar mbi emetimin e dioksidit të karbonit nga sektori i transportit të BE-së.*
- *Kjo politikë gjithashtu synon t'ju ofrojë kompanive në sektorin e transportit informacionin e nevojshëm për të administruar emetimet. Kjo mund t'i ndihmojë ato për të monitoruar emetimet e tyre dhe mund t'i nxisë për procese/pajisje të reja me qëllim reduktimin e emetimeve.*
- *Kjo politikë gjithashtu do t'i ofrojë aksionarëve dhe investitorëve informacion krahasues, i cili do të bëjë të mundur të vlerësojnë nëse performanca e kompanisë reflekton përgjegjësitë e korporatës për të marrë parasysh risqet dhe sfidat e paraqitura nga ndryshimet klimatike.*

Hapi 3: Identifikimi i opsioneve



Hapi i tretë i procesit të VN-së konsiston në identifikimin dhe vlerësimin e të gjitha opsioneve për ndërhyrje.

Të gjitha VN fillojnë me opsionin e “nivelit bazë” ose ajo që njihet ndryshe si ‘status quo’. Opsioni i “nivelit bazë” vepron si bazë përkundrejt së cilës maten të gjitha opsionet e tjera. Është pikërisht ndryshimi nga opsioni i “nivelit bazë” dhe ndikimi i tij që duhet të matet.

Analiza në këtë pjesë të VN-së duhet të përfshijë identifikimin e të gjitha opsioneve, duke përfshirë edhe atë të “nivelit bazë”, të legjislacionit dhe të alternativave të tij (p.sh., fushata edukimi dhe ndërgjegjësimi, përmirësimi i mënyrës se si zbatohet legjislacioni ekzistues etj). Analiza duhet gjithashtu të shpjegojë se si janë zgjedhur alternativat e listuara dhe nëse ka ndonjë mangësi në identifikimin e ndikimit në grupet e synuara, ndërkohë që nevoja për kërkime apo të dhëna të mëtejshme mund të bëhet si pjesë e konsultimeve.

Minimalisht ministritë përgjegjëse duhet të parashikojnë të paktën dy opsione në VN (pra përveç opsionit ‘status quo’) që duhet të analizojnë e të marrin në konsideratë.

Për të përcaktuar opsionet duhet të vlerësohet përvoja shqiptare dhe ajo ndërkombëtare (të paktën rajonale), si dhe mendimet e qëndrimet e palëve të interesuara të marra përmes procesit të

konsultimit publik. Në tabelën më poshtë jepet një shembull hipotetik për të treguar opsionet e mundshme:

Politikat për të rritur sigurinë në çerdhe

Qeveria shqiptare po konsideron të ndërmarrë një politikë për të shtuar sigurinë në çerdhe duke rritur aftësitë e stafit të çerdheve. Objektivi i qeverisë është të sigurojë që çerdhet të ofrojnë ambient të sigurt për fëmijët, por një politikë e re nuk vendos kosto joproporcionale mbi biznesin. Opsionet e mëposhtme janë marrë në konsideratë për të realizuar këtë objektiv:

Opsioni 0 – Niveli bazë – nuk pësojnë ndryshim kërkesat aktuale (p.sh. nuk ka kërkesa për të pasur staf të shpejtë të pajisur me certifikatë)


Opsioni 1 (jo rregullator) –prezantimi i një skeme vullnetare, e cila synon të inkurajojë stafin e çerdhes për të pasur trajnime të ndihmës së shpejtë.

Opsioni 2 (rregullator) - t'i kërkojë të gjithë stafit të çerdhes të pajisen me certifikata të ndihmës së shpejtë.

Opsioni 3 (rregullator, i preferuar) – t'i kërkojë çerdheve të kenë të paktën një person të pajisur me certifikatë të ndihmës shpejtë, prezent në çdo kohë bashkë me fëmijët.

Nëse nuk ka të dhëna të disponueshme, atëherë drejtuesit e politikave duhet të vlerësojnë nëse studimi duhet të ndërmerret apo jo për të mbështetur punën e mëtejshme për propozimin në fjalë (dhe monitorimin e vlerësimit të tij).

Hapi 4: Vlerësimi i opsioneve dhe analizimi i ndikimeve të tyre



Analizimi i ndikimeve të opsioneve të ndryshme është një hap i rëndësishëm në procesin e VN-së. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin e përfitimeve, kostove, risqeve kundrejt nivelit bazë.

Cilat janë përfitimet, kostot dhe risqet?

Përfitimet: përmirësojnë situatën për disa njerëz, grupe, organizata apo shoqëri. Si p.sh. rritja e pasurisë së tyre, përmirësimi i shëndetit të tyre, rritja e niveleve të tyre të arsimit, rritja e mundësive të tyre. Për bizneset, përfitimet mund të arrihen me anë të zgjerimit të pjesës së tyre të tregut, uljes së barrës administrative me të cilën ata përballen dhe rritjes së marzhit të tyre të fitimit. Përfitimet shoqërore mund të jenë shumë të vështira për t'u matur dhe mund të përfshihen në VN bazuar në vlerësime/llogaritje të arsyeshme ose si përfitime cilësore.

Ndonjëherë ka përfitime për disa grupe dhe kosto për grupe të tjera. Kjo është një çështje kapitali, e cila mund të theksohet dhe të vlerësohet në vetë VN.

Për shembull, a duhet të paguhen tarifat universitare nga vetë studentët (përmes kredive që do të paguhen nga të ardhurat në vitet në vijim), nga prindërit, nga taksapaguesit në përgjithësi apo një kombinimi i të tria alternativave?

Kostot: përkeqësojnë situatën për disa njerëz, grupe, organizata apo shoqëri. Për njerëzit, kjo mund të ndodhë përmes reduktimit

të të ardhurave të individëve ose përmes kufizimit të lirive të tyre. Për bizneset, kjo mund të ndodhë përmes vendosjes së pengesave administrative ndaj tyre duke ulur marzhin e tyre fitimprurës apo hapjen e tyre në tregun e konkurrencës së jashtme (nga kjo e fundit mund të përfitojë shoqëria përmes çmimeve më të ulëta, por me kosto për bizneset individuale përmes reduktimit të pjesës së tyre të tregut). Kostot mund të marrin ose formën e humbjeve ose të përfitimeve të munguara.

Risqet: parashikojnë ato situata, të cilat mund të shkojnë keq si pasojë e ndërhyrjes së politikës së propozuar. Disa risqe mund të parashikohen paraprakisht dhe, në këto raste, duhet të merren veprime për t'i zbutur ato. Duhet të përfshihen edhe pasojat e mundshme të padëshiruara. Përfshirja e palëve të interesuara në fillim mund të ndihmojë për identifikimin e risqeve dhe për gjetjen e zgjidhjeve për t'i zbutur ato.

Përfitimet dhe kostot (dhe risqet, nëse janë duke u marrë veprime për t'i zbutur ato) duhet të shqyrtohen në detaje, dhe kur është e mundur, ato duhet të monetarizohen. Përcaktimi i vlerës monetare mundëson krahasim të drejtpërdrejtë në mes të opsioneve të politikave. Nëse përfitimet dhe kostot nuk mund të monetarizohen, atëherë opsionet ende mund të krahasohen, por është thjesht më e vështirë për ta bërë këtë pasi kjo do të kërkojë që të bëhen gjykime dhe jo një vendim i qartë.

Tranzicioni kundrejt kostove, përfitimeve dhe transfertave periodike

Përfitimet, kostot dhe risqet mund të ndahen në ato që rezultojnë nga *tranzicioni* (kosto që krijohet një herë dhe përfitimet) dhe ato që janë të vazhdueshme ose të përsëritura (kosto të

vazhdueshme dhe përfitimet). Përfitimet, kostot dhe risqet e tranzicionit janë ato që kufizohen në periudhën kohore mes pikës në të cilën vendoset ndryshimi i politikës dhe pikës në të cilën politika parashikohet të ketë hyrë plotësisht në fuqi (që lidhet zakonisht me kostot/përfitimet shtesë që shoqërojnë zbatimin e politikës). Gjatësia e kësaj periudhe do të varet nga vetë ndërhyrja e politikës.

Përfitimet, kostot dhe risqet *e vazhdueshme ose periodike* janë ato që janë të lidhura me ndërhyrjen e politikës në afat më të gjatë. Kështu, për shembull, nëse ndërtohet një shkollë e re, atëherë kostoja e vetë ndërtesës është një kosto tranzicioni. Kostot e rritura të personelit në shkollë janë një kosto e vazhdueshme, ndërkohë që përmirësimi i edukimit që shkolla ofron për fëmijët është një përfitim i vazhdueshëm ose periodik.

Disa nga ndikimet e politikave kanë të bëjnë me transferimin e shpenzimeve nga një grup i ekonomisë në një tjetër. Këto lloj kostosh duhet të kategorizohen si *transferta* ekonomike. Këto lloj kostosh zakonisht nuk kanë ndikim neto në ekonomi (pasi një grup përfiton dhe një grup tjetër humbet), pra këto shifra nuk kanë ndikim në shifrën neto të përfitimit për një politikë. Megjithatë, llogaritja e kostos/përfitimit të transferimit dhe diskutimi në VN është e rëndësishme pasi ajo të shpjegojë ndikimin e plotë mbi grupe të caktuara të ekonomisë.

Opsioni ‘status quo’ dhe analizimi i ndikimit shtesë (matja e ndryshimit)

Brenda çdo raporti VN duhet të merret në shqyrtim opsioni ‘*status quo*’. Nuk është e domosdoshme për të kuptuar dhe mbështetur arsyetimin për ndërhyrjen e qeverisë, por është

shumë e rëndësishme për përcaktimin e kostove dhe përfitimeve të të gjitha opsioneve të tjera që shqyrtohen. Opsioni i nivelit bazë duhet të shpjegojë situatën dhe ndryshimet e saj të mundshme pas kryerjes së ndërhyrjes së propozuar nga qeveria. Si i tillë, opsioni i status quo-së shërben si "bazë fillestare" për analizën dhe vlerësimin e opsioneve të reja alternative.

Të gjitha kostot dhe përfitimet e opsioneve duhet të vlerësohen mbi atë bazë. Baza fillestare në vetvete mund të ndryshojë gjatë procesit të vlerësimit, pa marrë parasysh asnjë ndërhyrje. Kjo mund të ndodhë si rezultat i një rregullimi ose ligji që hyn në fuqi gjatë fazës së planifikuar të zbatimit të ligjit të ri. Prandaj, ndikimi faktik i ligjit të ri duhet të marrë parasysh ndikimin e pritshëm të ndonjë ligji apo rregulloreje tjetër që ndikon në bazën fillestare.

Analiza e opsioneve duhet të fokusohet në kostot dhe përfitimet shtesë (kosto dhe përfitimet shtesë ose marginale) krahasuar me gjendjen e status quo-së me opsionin e "status quo-së" (një situatë kur asgjë nuk ka ndodhur). Me fjalë të tjera, për çdo opsion llogariten dhe diskutohen vetëm kostot dhe përfitimet shtesë (të reja) në VN. Për shembull, në qoftë se projektligji kërkon që tarifa për licencat vjetore të rritet me 20%, në analizë duhet të përfshihet vetëm kostoja e rritjes. Në mënyrë të ngjashme, përfitimet duhet të përfshijnë vetëm përfitimet shtesë si krahasim ndaj opsionit të "status quo-së".

Për çdo opsion, ekipi i politikave duhet:

- Të identifikojë se kush është prekur, cili është grupi i synuar;

- Të identifikojë llojet e ndikimeve (ekonomike, sociale, mjedisore etj) për çdo grup të prekur; Të bëhet dallimi midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta;
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Të përshkruajë në mënyrë cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura;
 - Të analizojë në mënyrë sasiore ndikimet e drejtpërdrejta më të rëndësishme;
 - Të monetarizojë ndikimin në ndërmarrjet e vogla e të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Të përshkruajë në mënyrë cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e synuara;
 - Të analizojë ndikimet mbi konkurrencën.
- Të hartohen supozimet mbi të cilat bazohen parashikimet dhe risqet të cilave ato i nënshtrohen. Të shprehet se sa të fuqishme, të pavarura dhe të rëndësishme janë dëshmitë që mbështesin këto supozime. Të parashikohet se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, rritjen e kostove apo që mund të shkaktojë rezultate të papritura.
- Të bëjë një përmbledhje të vlerësimit të alternativave të mundshme:
 - Të paraqesë një përmbledhje të të gjitha ndikimeve për alternativat e mundshme të analizuara;
 - Të shpjegojë se si ndikimi i alternativave të mundshme të analizuara krahasohet me të tjera;

- Të paraqesë vlerësimin më të mirë të të gjitha ndikimeve neto të monetarizuara për çdo alternativë të mundshme.

Ndikimet ekonomike (përfshirë ato financiare), sociale dhe mjedisore

Ndikimet dhe pasojat e një politike mund të kategorizohen në 3 (tri) grupe kryesore: ekonomike (përfshirë ato financiare), sociale dhe mjedisore. (shiko aneksin 2 të kësaj metodologjie).

Ndikimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta

Ndikimet e drejtpërdrejta janë ato që i atribuohen drejtpërsëdrejti politikës së propozuar dhe drejtpërsëdrejti ndihen nga grupet e prekura si rezultat i ndërhyrjes së qeverisë. Për shembull, vendimi për të rritur tarifën e regjistrimit të automjeteve, drejtpërsëdrejti ndikon mbi pronarët e automjeteve pasi rrit koston e mbajtjes së automjetit.

- Kostot e drejtpërdrejta mund të përfshijnë:
 - detyrimet rregullatorë, përfshirë tarifën, taksat dhe licencat;
 - kostot e politikave – këto përfshijnë investimet dhe shpenzimet e biznesit, qytetarëve dhe autoriteteve publike me qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas ligjit (psh. për pajisjet, punën, materialet, shërbimet e jashtme etj);
 - kostot administrative, që janë kostot e lidhura kryesisht me përputhshmërinë dhe familjarizimin me kërkesat e politikës së re dhe/ose kostot e problemeve që lidhen me kërkesat e reja të zbatimit dhe të monitorimit të sjella nga rregullimi i ri. Për shembull, në qoftë se qeveria paraqet

një kufizim për ekspozimin e produkteve të duhanit në dyqane, kjo do të krijojë kosto shtesë administrative për pronarët e dyqaneve që duhet të veprojnë në përputhje me rregullimin e ri (pasi ata duhet të vënë raftë shtesë dhe të mbulojnë produktet e duhanit, dhe të bëjnë disa përshtatje administrative për vetë procesin e shitjes). Megjithatë, ndikimi i politikës së këtij rregullimi të ri është reduktimi i shitjes së duhanit dhe i përfitimeve në drejtim të reduktimit të vdekjes për shkak të përdorimit të duhanit, gjë e cila është edhe objektivi përfundimtar i politikës.

- kostot e buxhetit, që janë kostot që lidhen me implikimet buxhetore dhe burimet njerëzore dhe administrative të lidhura me ndërhyrjet/alternativat e mundshme të politikave.
- përfitimet e drejtpërdrejta që mund të përfshijnë përmirësimin e mirëqenies së individëve ose mjedisit (shëndeti, siguria, gjendja e mjedisit e përmirësuar etj) dhe përmirësimet e efikasitetit të tregjeve, të tilla si: reduktimi i kostove dhe disponueshmëria e informacionit.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta janë ato që lidhen me ndryshimet e sjelljeve ose ndikimin e tregjeve dhe konkurrencës dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë të synuara nga alternativat e mundshme të politikave/iniciativave.

- kostot jo të drejtpërdrejta zakonisht që transmetohen ndërmjet ndryshimeve të çmimeve, ndryshimeve të cilësisë ose ndryshimeve në disponueshmërinë e

mallrave/shërbimeve të prodhuara në një sektor të rregulluar;

- përfitimet jo të drejtpërdrejta që mund të përfshijnë përfitime makroekonomike më të gjera (GDP, produktivitetin, përqindjen e punësimit etj) si dhe përfitime të tjera jo të monetarizuara, të tilla si: të drejtat e njeriut, zvogëlimi i diskriminimit, përmirësimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë.

Metodat e vlerësimit

Analiza mund të bëhet duke përdorur teknika dhe mjete të ndryshme, të tilla si analiza e kosto-përfitimit, analiza e kosto-efektivitetit. Qëllimi i këtij hapi është që të sigurojë prova të mjaftueshme për të krahasuar kostot dhe përfitimet e secilit opsion individual dhe për të përcaktuar opsionin që jep rezultatin më të mirë të mundshëm në kohën e tanishme.

Niveli i analizës së secilit opsion do të ndryshojë në varësi të llojit dhe natyrës së propozimit të politikave. Si minimum, analiza duhet të ndihmojë për çdo opsion të politikave që identifikohen grupet kryesore dhe aktorët të cilët preken nga propozimi i politikave dhe duhet të sigurojë vlerësimet sasiore në lidhje me numrin e grupeve të prekura. Duhet të përfshihet sa më poshtë vijon:

- Identifikimi i grupeve të prekura të sektorit publik, i biznesit dhe i organizatave të shoqërisë civile dhe i qytetarëve.
- Përshkrimi cilësor i ndikimeve në grupet e prekura (p.sh., shitjet me pakicë do të ndikohen negativisht).

- Përcaktimi i masës së ndikimit të grupeve të prekura (p.sh., X/% grup-mosha e biznesit të prekur).
- Përcaktimi i vlerës monetare të shpenzimeve të propozimit duke vënë përlogaritjet e vlerës financiare (rekomandohet për VN-në, kërkohet me detyrim për VN-në në fazën e fundit të zhvillimit të politikave).
- Përcaktimi i plotë i vlerës monetare të të gjitha kostove dhe përfitimeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte në sektorët publikë, privatë dhe OSHC.

Analiza e kosto-përfitimit (AKP) është një metodë e analizës sasiore ekonomike e përdorur në vlerësimin dhe renditjen e politikave dhe rregullimeve alternative. Ajo është metoda që përdoret më shumë për analizën e VN-së dhe metoda kryesore e analizave kur është i mundur përcaktimi i vlerës monetare të ndikimeve. Edhe kur përcaktimi i vlerës monetare të ndikimeve nuk është i mundur duhet të përdoret qasja e analizës së kosto-përfitimit për të vlerësuar ndikimet dhe për të krahasuar opsionet me anë të përdorimit të vlerësimit cilësor të ndikimeve. Kur zbatohet dhe paraqitet në mënyrë sistematike, ajo mund të ndihmojë për të krahasuar opsionet e ndryshme. Më shumë detaje mbi analizën e kosto – përfitimit dhe metodat e tjera të vlerësimit, si dhe shembujt përkatës janë paraqitur në pjesën e 3 të kësaj Metodologjie.

Hipotezat

Analiza brenda VN varet shumë nga hipotezat. Hipotezat kanë një rol të madh për mbështetjen e të gjithë analizës së përfitimeve, kostove dhe risqeve. Për shkak se nuk është e mundur që të thuhet me siguri absolute se çfarë do të ndodhë,

atëherë do të duhet që të paktën disa analiza të bazohen në hipoteza. Ato duhet të bazohen në përvojën paraprake dhe në të dhënat në dispozicion sa më shumë që të jetë e mundur. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë është i dobishëm një justifikim teorik për supozimet e bëra. Është shumë e rëndësishme për të qenë i qartë në lidhje me supozimet e bëra dhe se në çfarë janë bazuar ato, pasi kjo do ta bëjë të qartë se pse mendohet që opsionet e politikave që janë diskutuar do të rezultojnë në përfitimet, kostot dhe risqet që janë vlerësuar.

Ndikimet në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Për shkak të rëndësisë së bizneseve të vogla dhe të mesme në zhvillimin dhe rritjen e sektorëve e të zonave të caktuara të vendit, analiza e ndikimit mund të çmojë edhe analizën dhe provat e veçanta mbi ndikimin e mundshëm të politikës ndaj ndërmarrjeve të vogla e të mesme (më poshtë referuar “NVM”). Në aneksin 3 të kësaj Metodologjie paraqitet testi i NVM-ve, ku përfshihen disa pyetje me qëllim vlerësimin e ndikimit të NVM-së.

Subjektet e biznesit të përmendura në vlerësimin e një fushe të caktuar ekonomike i referohen:

- Subjekteve mikroekonomike me më pak se 10 të punësuar.
- Bizneseve të vogla, nga 10 deri në 49 të punësuar.
- Bizneseve të mesme, nga 50 deri në 249 të punësuar.
- Korporatave të mëdha, me më shumë se 250 të punësuar.

Ndikimi te konkurrenca

VN duhet gjithashtu të konsiderojë vlerësimin e konkurrencës për të vlerësuar nëse politika e propozuar do të ketë ndikim te konkurrenca apo jo. Nëse këto ndikime nuk janë identifikuar si domethënëse, kjo duhet të përmendet në raportin e VN-së.

Në aneksin 4 të kësaj Metodologjie paraqitet testi i konkurrencës, ku përfshihen disa pyetje me qëllim vlerësimin e ndikimit të konkurrencës.

Kriteret dhe testet e përmendura në këtë Metodologji nuk janë shteruese, prandaj fusha më të gjera dhe ndikime të mundshme të politikave duhet të konsiderohen specifike për fushën ekonomike apo sektorin që është në shqyrtim.

Në varësi të politikës në shqyrtim, vetëm disa nga këto ndikime mund të jenë të rëndësishme për analizën e Vlerësimit të Ndikimit. Ndërkohë, është e rëndësishme që të shqyrtohen ndikimet kundrejt këtyre kriterëve dhe kriterëve të tjera specifike për të siguruar se në Vlerësimin e Ndikimit është marrë parasysh ndikimi i plotë.

Periudha kohore e analizës

Disa ndikime të politikave materializohen gjatë një periudhe më të gjatë kohore. Kjo është e rëndësishme veçanërisht për politikat që kanë për qëllim të ndikojnë në sjelljet e biznesit apo të qytetarëve. Prandaj, ekipi i VN-së duhet të marrë parasysh periudhën e duhur kohore të analizës që do të sigurojë se gjatë vlerësimit është marrë parasysh ndikimi i plotë i politikës së re.

Kjo duhet të jetë zakonisht jeta e pritshme e një politike apo projektakti të veçantë. Kur kjo periudhë nuk është e mundur që

të krijohet, atëherë rekomandohet të përdoret periudha e 10 viteve. Megjithatë, për ndikimin mbi buxhetin, periudha 3-vjeçare rekomandohet.

Gjatë kryerjes së analizave për një periudhë më të gjatë duhet të ketë edhe ulje të kostove dhe përfitimeve të monetarizuara.

Cilësia dhe disponueshmëria e të dhënave

Cilësia e VN-së varet shumë nga qëndrueshmëria dhe besueshmëria e të dhënave dhe dëshmime të përdorura në analizë, veçanërisht për ato të dhëna dhe informacione të disponueshme, të cilat janë të rëndësishme për problemin e politikave e të opsioneve që janë duke u shqyrtuar.

Është e rëndësishme që për të dhëna dhe statistika të përdoren burimet zyrtare (p.sh., raportet e qeverisë, statistikat e INSTAT-it për të gjetur numrin e ndërmarrjeve apo individëve të prekur nga politikat në sektorë të caktuar etj). Ministritë mund të përdorin gjithashtu edhe raportet dhe vlerësimet e tyre të brendshme, si dhe kërkimet e studimet e kryera nga organet dhe organizatat e jashtme, por për këto duhet të ketë referenca të qarta.

Gjatë analizimit të ndikimit të politikave dhe rregulloreve të BE-së, raporti i VN-së i përgatitur nga Komisioni Evropian mund të jetë një burim i vlefshëm të dhënash dhe informacionesh për të analizuar ndikimin mbi ekonominë shqiptare.

Është përgjegjësi e ekipit përkatës të VN-së të sigurojë që në provat dhe analizat që mbështesin rekomandimin e politikave të përdoren të dhëna të fuqishme dhe të sakta.


Burimet e të dhënave dhe informacionit të përdorur në Vlerësimin e Ndikimit duhet të përfshihen në raportin e VN-së. Ekzistojnë shumë burime të disponueshme prej të cilave mund të merren të dhëna dhe dëshmi për VN-në.

Të dhënat statistikore

- Të dhëna statistikore kombëtare: disa burime të nevojshme jepen më poshtë:
 - INSTAT: www.instat.gov.al;
 - Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG): <https://geoportal.asig.gov.al/>;
- Të dhëna statistikore ndërkombëtare: disa burime të nevojshme sipas fushave të ndryshme jepen më poshtë:
 - Eurostat – është zyra statistikore e BE-së. Ajo ofron të dhëna për të gjitha politikatat e vendeve anëtare. <http://ec.europa.eu/eurostat/data/database>;
 - OECD – <https://stats.oecd.org/>
 - Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë: www.iea.org;
 - Organizata Botërore e Tregtisë: www.wto.org;
 - Banka Botërore: <http://data.worldbank.org>;
 - Fondi Monetar Ndërkombëtar: www.imf.org;
 - Industria e naftës e BE: www.fuelseurope.eu;
 - Prodhuesit evropianë të automjeteve të BE-së (ACEA): www.acea.be;
 - Shoqata Evropiane e Çelikut (EUROFER): www.eurofer.org;

- Agrobiznesi/Bujqësia/Blegtoria (COPA- COGECA):
<http://www.copa-cogeca.be>

Hapi 5: Zgjedhja e opsionit më të mirë



Hapi tjetër është vlerësimi dhe krahasimi i opsionit të politikave për të përcaktuar se cili prej tyre justifikon ndërhyrjen e qeverisë duke demonstruar në mënyrë të qartë se opsioni i propozuar do të japë përfitime maksimale. Nëse përfitimet tejkalojnë kostot, atëherë politika/ projektakti/rregullimi është i justifikueshëm. Ka dy elemente që duhet të merren parasysh:

1. Disavantazhet dhe avantazhet e opsionit të zgjedhur për përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme.
2. Cili prej opsioneve sjell dobinë më të lartë neto.

Rezultati i analizës kosto-përfitim do të sigurojë informacionin e nevojshëm për të marrë vendimin dhe për të përzgjedhur opsionin më të mirë që pritet të japë përfitimin më të lartë neto. Nëse ka më shumë se dy opsione të cilat tregojnë se përfitimet janë më të larta se kostoja, atëherë duhet të përzgjidhet dhe rekomandohet për zbatim opsioni që pritet të japë përfitimin më të lartë neto (përfitime - kosto).

Janë të disponueshme mjete dhe teknika të tjera analitike (p.sh. ajo e kosto-efektivitetit, kosto-efikasitetit, analiza me shumë kritere etj.) dhe mund të përdoren për të bërë krahasimin final të alternativave (Shih pjesën III). Në tabelën e mëposhtme

paraqitet një shembull hipotetik për të përshkruar zgjedhjen e opsionit të preferuar:

Politikat për të vendosur sistemin e licencimit të pompave të ujit

Janë vlerësuar 3 opsione për VN-në:

Opsioni 0 – niveli bazë (status quo);

Opsioni 1 – përcaktimi i kërkesave vjetore të licencimit për të gjitha pompat e ujit pa parashikuar një periudhë kalimtare.

Opsioni 2 (i preferuar) - përcaktimi i kërkesave vjetore të licencave për të gjitha pompat e ujit duke parashikuar një periudhë kalimtare 3-vjeçare.

Analiza e kosto – përfitimit ka vlerësuar vlerën aktuale neto të opsioneve 1 dhe 2 në krahasim me opsionin 0. Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të vlerësimit:


Opsioni	Vlera aktuale në mln lekë		Vlera aktuale neto
	Kosto	Përfitime	
Opsioni 1	5.5	0.8	- 4.7
Opsioni 2	4.7	0.7	- 4.0

Analiza tregon se të dyja opsionet do të rezultojnë me kosto neto. Kostot për opsionin 1 janë më të mëdha për shkak të fillimit të menjëhershëm të zbatimit të kërkesave të licencimit dhe ndikimit pasues te biznesi. Ndërkohë për opsionin 2, rregullimet kalimtare lejojnë për 3 vjet shmangien e kostove mbi biznesin, megjithatë njësoj vonojnë krijimin e përfitimeve te mjedisi sipas ligjit.

Për të dyja opsionet, kombinimi i përfitimeve jo të monetarizuara dhe kërkesat e legjislacionit të EU-së ofrojnë arsyetimin për veprim të të dyja opsioneve me rezultatin e kostove neto. Në tërësi, bazuar në analizën cilësore të ndikimeve jo të monetarizuara, ne besojmë se totali i përfitimeve (të monetarizuara dhe jo të monetarizuara) i tejkalon kostot në të dyja opsionet.

Opsioni 2 është opsioni i preferuar. Zgjedhja midis opsionit 1 dhe 2 është bërë sepse ky opsion do t'i lejojë pompat e ujit të përshtasin veprimet e tyre në përputhje me licencat, prandaj duke rezultuar me kosto më të ulët, mendojmë se 3 vjet nuk përbëjnë një vonesë jo të paarsyetuar të përfitimeve në mjedis.

Hapi 6: Çështje të zbatimit



VN duhet të përdoret për të diskutuar dhe për të marrë parasysh çështjet e zbatimit përgjatë gjithë procesit të VN-së. Për shkak se shpesh ka shumë kosto dhe risqe që përshihen në zbatim, analiza e këtyre çështjeve është gjithashtu e rëndësishme gjatë fazës së vlerësimit të opsioneve.

Megjithatë, çështjet e zbatimit bëhen edhe më të rëndësishme kur përzgjidhet mundësia faktike e politikës përkatëse. VN duhet të diskutojë dhe të shpjegojë se si është planifikuar të zbatohet politika e re, duke përfshirë afatin kohor të aktiviteteve kryesore, burimet e financimit dhe mekanizmat e zbatimit. Për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e opsionit të preferuar, është e nevojshme që të identifikohet:

- Njësia përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikës apo projektaktit.
- Kriteret/treguesit për matjen e arritjes së qëllimeve apo progresin drejt tyre.

- Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të përzgjedhur.
- Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit në mënyrë që të arrihen objektivat e politikës.

Çështje të pajtueshmërisë dhe të zbatimit

Hapat, që duhet të merren për të siguruar që përputhshmëria dhe zbatimi janë realizuar, përfshijnë sa më poshtë vijon:


- Specifikimin e qartë të të gjitha kërkesave të pajtueshmërisë dhe të zbatimit.
- Sigurimin që kostot e zbatimit të politikave janë identifikuar të gjitha duke përfshirë edhe kërkesat për burimet njerëzore.
- Diskutimin e opsioneve të pajtueshmërisë me grupet e interesit (si me palët e interesuara të brendshme ashtu edhe me ato të jashtme); kjo mund të bëhet në të gjitha fazat përkatëse të procesit për të siguruar se opsioni që është përzgjedhur mund të përmbushet dhe të zbatohet.

Në tabelën më poshtë paraqitet një shembull hipotetik për të treguar si pëshkruhet plani i zbatimit dhe hyrjes në fuqi:

Politika për të vendosur pagën minimale në vend.
Politika e pagës minimale në vend do të zbatohet duke filluar nga viti pasardhës financiar. Për këtë do të ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
Ministria do të vërë në dispozicion të punëmarrësve një numër të gjelbër për ankesat nëse ata nuk do të marrin pagën minimale.
Në vijim, ministria do të kryejë kontrolle në sektorë ku rreziku që punëmarrësit të mos paguhen me pagën minimale sipas ligjit është

më i madh. Nëse ministria zbulon një rast ku një punëdhënës nuk zbaton dhënie e pagës minimale sipas ligjit, ky punëdhënës do të duhet t'i kthejë mbrapsht gjithë pagesën e prapambetur, punëmarrësve, bashkë me gjokat përkatëse.

Hapi 7: Faza e shqyrtimit dhe vlerësimit



Pas përfundimit të planeve për monitorimin e zbatimit është gjithashtu e nevojshme që të vlerësohet opsioni që po zbatohet. Vlerësimi kryhet zakonisht pas fillimit të zbatimit. Qëllimi i vlerësimit është të çmojë nëse opsioni i zbatuar ka zgjidhur problemin e përcaktuar dhe ka arritur qëllimet e variantit të preferuar *pas një periudhe të caktuar kohe (jo më herët se 3-5 vite)*. Pyetjet që mund të ndihmojnë vlerësimin e iniciativës janë:

- A ekziston ende problemi identifikuar dhe se është përsëri e nevojshme ndërhyrja e qeverisë në të njëjtën shkallë ose në një masë më të vogël?
- A janë regjistruar përmirësime të dukshme të zgjidhjes së problemit që nga koha kur rregullimi ka hyrë në fuqi?
- A janë arritur qëllimet e legjislacionit? A janë arritur qëllimet e përcaktuara në VN?
- A është ndikimi i opsionit të zbatuar, domethënë legjislacioni, i barabartë me pritshmëritë?
- A ka pasur pengesa, ndikime dhe probleme që nuk pritëshin?

- A është legjislacioni ekzistues në fuqi ende i përshtatshëm për zgjidhjen e problemit dhe arritjen e qëllimeve të legjislacionit, domethënë të politikave publike?
- A mund të jetë e dobishme përvoja e zbatimit të këtij opsioni për të përmirësuar masat dhe për të arritur qëllimet?
- A ekziston një boshllëk i madh aftësish që duhet të plotësohet?

Në tabelën më poshtë paraqitet një shembull hipotetik për të treguar si të përshkruhet plani i monitorimit dhe vlerësimit:

Politika për vendosjen e gjobave në rast të përdorimit të telefonave gjatë kohës së lëvizjes me makinë

Ne planifikojmë të vlerësojmë këtë politikë 3 vjet pas zbatimit të saj. Kjo politikë pritet të ketë ndikim mbi sjelljen e drejtuesit të automjetit (gjoba ka si qëllim heqjen e përdorimit të telefonave kur i japim makinës) dhe ne planifikojmë të mbledhim të dhënat e mëposhtme:

- Të dhëna mbi gjobat e lëshuara nga policia për ata që do të kryejnë shkeljen më sipër;
- Të dhëna nga Ministria e Drejtësisë mbi ndjekjet penale për shkeljet e mësipërme.

Të dhënat e mbledhura për monitorim do të krahasohen me të dhënat nga periudha e nivelit bazë, përpara se të bëheshin ndryshimet për VN-në.

Ne gjithashtu planifikojmë të kryejmë një sondazh ndërmjet drejtuesit të automjeteve për të mbledhur prova cilësore mbi ndikimin e kësaj politike. Provat do të krahasohen me rezultatet e sondazhit të kryer për këtë VN.

Në vijim, do të angazhohemi me aktorët kyç si ata të sigurisë rrugore dhe organizatat e shoqërisë civile si dhe forcat ligjzbatuese (policia, policia rrugore) për të mbledhur mendimet e aktorëve mbi ndikimin e kësaj politike.

Pjesa III: Metodatat e vlerësimit

Gjatë analizimit të opsioneve del e nevojshme mbledhja e të dhënave për impaktin financiar të zbatimit të projektligjit apo politikës përkatëse me qëllim vlerësimin nëse kostot tejkalojnë apo jo përfitimet. Vetëm në këto kushte mund të vlerësohet nëse iniciativa e qeverisë duhet çuar përpara. Duke qenë se raporti i vlerësimit të ndikimit është një dokument publik, çdo e dhënë në të duhet të jetë shprehur qartë dhe me një gjuhë të thjeshtë për këdo, pavarësisht nivelit të ekspertizës.

Qëllimi është që gjatë vlerësimit të opsioneve të ndryshme për ndërhyrje, përfitimet dhe kostot përkatëse të paraqiten përmes statistikave, shifrave dhe raporteve në terma sasiorë. Ka disa metoda për vlerësimin e kostove dhe përfitimeve, ndër të cilat: analiza e kosto – përfitimit, analiza e kosto - efektivitetit dhe analiza me shumë kritere.

Analiza e kosto - përfitimit krahason opsionet duke llogaritur në vlerë monetare kostot dhe përfitimet.

Analiza e kosto - efektivitetit krahason kostot që nevojiten për arritjen e një rezultati specifik.

Analiza me shumë kritere është një mjet që duhet të aplikohet vetëm kur dy metodat e mësipërme nuk mund të zbatohen. Kjo metodë përdoret për të krahasuar opsionet që nuk mund të kuantifikohen lehtë.

Analiza e kosto – përfitimit

Analiza e kosto – përfitimit konsiderohet si praktika më e mirë për t'u ndjekur në rastin e kryerjes së VN-së. Ajo krahason opsionet përmes llogaritjes së vlerës monetare të kostove dhe përfitimeve. Ajo është metoda më e qëndrueshme për analizën e zgjidhjeve rregullatore.

Kjo metodë konsiston në llogaritjen e ndikimit neto total (përfitim - kosto) që rezulton nga një politikë/projektakt specifik. Sa herë që përfitimet janë më të mëdha se kostot, ne duhet ta konsiderojmë rregullimin e planifikuar ligjor si të justifikuar. Megjithatë, mund të ketë raste që analiza e kosto - përfitimit të tregojë se ndërhyrja do të ketë vetëm kosto neto sepse shpesh është e pamundur të monetarizohen përfitimet. Politikëbërësit ende mund të marrin në konsideratë këto lloj ndërhyrjesh si të preferuara nëse, bazuar në analizën cilësore të ndikimeve jo të monetizuara, ata janë në gjendje të japin një gjykim se përfitimi total i përgjithshëm (të monetarizuara dhe jo të monetarizuara) tejkalon koston totale. Natyra e gjithanshme e kësaj analize konsiston në faktin që ajo lejon shqyrtimin e të gjitha aspekteve të një mase të propozuar.

Ekzistojnë dy lloje të kësaj analize: 1) analizë kosto-përfitim e plotë, në të cilën monetarizohen të gjitha kostot dhe përfitimet relevante; dhe 2) analizë kosto-përfitim e pjesshme, e cila aplikohet atëherë kur arrihet të monetarizohen vetëm kostot dhe përfitimet më të rëndësishme.

Kudo që vlerësimi i plotë i përfitimeve (apo kostove) është i pamundur, VN-ja duhet të paraqesë përshkrim sa më të plotë të mënyrës, sipas së cilës do të merren efektet e dëshiruara. Duhet gjithashtu që VN-ja të përfshijë për aq sa mundet kuantifikim të

ndikimeve jo të monetarizuara për të dhënë disa informacione mbi shkallën e çështjes. Nëse kuantifikimi është gjithashtu i pamundur, efektet duhet të diskutohen të paktën në mënyrë cilësore. Konkluzionet duhet të mbështeten në aspekte teorike të disponueshme dhe prova cilësore, duke përfshirë shembuj ilustrues, duke iu referuar gjithashtu pikëpamjeve të palëve të interesuara.

Kjo analizë është shumë e dobishme kur VN-ja trajton opsionin për të filluar një ndërhyrje krejtësisht të re, pasi kjo analizë tregon vlerën e shtuar të ndërhyrjeve të reja si '*ndikime neto*' dhe prandaj mundëson informacionin e duhur për të vlerësuar nëse ndërhyrjet ia vlejné apo jo. Kjo analizë është e këshillueshme të përdoret sidomos kur nisma rregullatore ka pritshmëri apo interes të lartë nga publiku.

Megjithatë kjo metodë ka gjithashtu disa kufizime, pasi ajo mbështetet mbi besueshmërinë e supozimeve dhe shpesh e kemi të pamundur t'i vendosim vlerë monetare përfitimeve.

Hapat e analizës së kosto - përfitimit

Analiza e kosto-përfitimit përfshin hapat në vijim:

1	•Identifiko grupet e prekura
2	•Identifiko llojet e kostove dhe përfitimeve për secilin grup
3	•Monetarizo të gjitha kostot direkte
4	•Monetarizo të gjitha përfitimet direkte
5	•Vlerëso kostot dhe përfitimet indirekte
6	•Skonto kostot e monetarizuara që të llogarisësh vlerën aktuale
7	•Skonto përfitimet e monetarizuara që të llogarisësh vlerën aktuale
8	•Llogarit vlerën aktuale neto
9	•Diskuto kufizimet e analizës
10	•Jep rekomandime të bazuara në analizë

Siç është përmendur edhe në këtë Metodologji, analiza e ndikimeve duhet të përqendrohet në kostot shtesë dhe përfitimet (kostot dhe përfitimet në rritje ose marxhinale), krahasuar me gjendjen e status quo-së ose opsionin bazë.

Si të monetarizojmë kostot dhe përfitimet duke përdorur këtë analizë

Kostot

Nëse propozimi imponon kosto apo barrë direkte te një grup i caktuar (p.sh. bizneset), duhen ndjekur hapat e mëposhtëm për të monetarizuar ndikimet vjetore:

- Identifiko grupin e prekur.
- Vlerëso numrin e bizneseve/individëve/organizatave në atë grup që do të duhet të përmbushin detyrimet duke paguar kostot.

- Vlerëso frekuencën e pagesës së kostove (1= një herë në vit; 2= dy herë në vit; 0.5= një herë në dy vjet etj).
- Vlerëso koston për njësi (kostoja e tarifës, licencës, lejes etj).
- Shumëzo këto tre parametra.
- Prezanto konkluzionet e analizës.

Në tabelën më poshtë jepet një shembull i thjeshtë për të ilustruar se si vlerësohen ndikimet nga vendosja e një tarife licence për operatorët në sektorin e telekomunikacionit.

Një shembull hipotetik për të treguar se si vlerësohen ndikimet që vijnë si pasojë e ndryshimit legjislativ/rregullator – masë e një politike që vendos një tarifë licence për operatorët në sektorin e telekomunikacionit.

Vendosja e një tarife licence prej 500 lekësh mbi operatorët e telekomunikacionit për t'u paguar dy herë në vit.

Për të kryer vlerësimin e ndikimeve të pritshme mbi bizneset e prekura duhet ndjekur hapat e mëposhtëm:

- *Identifiko grupin e prekur: operatorët në sektorin e telekomunikacionit.*
- *Vlerëso numrin e bizneseve/individëve/organizatave në atë grup që do të duhet të përmbushin detyrimet duke paguar kostot: 2500*
- *Vlerëso frekuencën e pagesës: 2 = dy herë në vit.*
- *Vlerëso koston për njësi të licencës: 500 lekë.*
- *Shumëzo këto tre parametra për të vlerësuar kostot vjetore: $2500 \times 2 \times 500 = 2.5$ milionë lekë.*
- *Prezanto konkluzionet e analizës.*

Kostoja vjetore e operatorëve në sektorin e telekomunikacionit që rezulton nga kjo politikë vlerësohet në 2.5 milionë lekë.

Kostot e politikave dhe kostot administrative

Nëse propozimi krijon apo rrit kostot e politikave (për shembull, një rregullim apo politikë kërkon që bizneset të blejnë materiale ose kostot e politikës së pajisjeve do të përfshijnë blerjen e këtyre materialeve ose pajisjeve) dhe/ose barra administrative (për shembull, një projektligj imponon detyrimin për t'i raportuar qeverisë disa aspekte të operacioneve të biznesit) hapat e mëposhtëm duhet të ndiqen për monetarizimin e ndikimit vjetor:

- Identifikoni detyrimin;
- Identifikoni grupin e prekur;
- Vlerësoni numrin e bizneseve / individëve / organizatave në atë grup që do të duhet të pajtohen me detyrimin;
- Vlerësoni kostot e:
 - përmbushjes së detyrimit, për shembull koston e blerjes së një makinerie të re dhe kostot operative e të mirëmbajtjes së asaj makine;
 - barrës administrative - shih më poshtë modelin e koston standarde për detaje.


Analiza e kosto - përfitimit zakonisht përdor metodën e Modelit të Koston Standarde (MKS) – i cili është një kuadër i thjeshtë për llogaritjen e koston së përgjithshme që sjell ndryshimin rregullator në ekonomi. Ai bazohet në përcaktimin e një

'aktiviteti' që do të kushtojë dhe përcaktimin e parametrave të mëposhtëm të koston:

- Tarifa: kostoja për njësi e kohëzgjatjes së një aktiviteti;
- Koha: koha totale e lidhur me aktivitetin;
- Popullsia: numri i bizneseve që preken;
- Frekuenca: numri i herëve në vit që çdo biznes duhet të kryejë aktivitetin.

Formula që përdoret në Modelin e Koston Standard është *kostoja e aktivitetit = Çmim x Sasi ku Çmim = kohë x tarifë dhe Sasi = frekuenca x popullata (nr. i grupit të prekur)*.

Ekuacioni për të monetarizuar koston administrative është si më poshtë:



Tarifa përshkruan koston për njësi të kohës (zakonisht një orë) të një aktiviteti të shprehur zakonisht si kosto e kohës së nevojshme për stafin e përfshirë në kryerjen e aktivitetit.

- Aktivitetet administrative mund të kryhen 'in house' nga vetë punonjësit e biznesit (pra tarifë e brendshme), ose mund të nënkontraktohen, siç janë kontabilistët dhe këshilltarët ligjorë (pra tarifë e jashtme).

- Tarifat e brendshme do të duhet të llogariten duke vlerësuar koston e punës. Kostoja e punës zakonisht përfshin pagën e paguar për punonjës, plus çdo kosto tjetër të punës përtej pagës, si p.sh., kontributi për sigurimet shëndetësore e shoqërore. Në mungesë të informacionit mbi normën e këtyre kostove të tjera përtej pagës, niveli i rekomanduar është 18.8% e koston së punës.
- Në përgjithësi, aktivitetet administrative kanë tarifa të ndryshme në varësi të nivelit të vjetërsisë në punë (kjo për arsye të pagës) të stafit që kryen aktivitetin. Është e rëndësishme të përcaktohet se cilët anëtarë të stafit brenda një biznesi do të ndërmarrin aspekte të veçanta të çdo aktiviteti administrativ.
- Praktikisht tarifat e jashtme do të jenë më të lehta për t'u vlerësuar, pasi thjesht do të jetë çmimi i shërbimeve të jashtme për biznesin që blen.

Koha e nevojshme për një aktivitet administrativ zakonisht përcaktohet në orë për të lejuar llogaritjen e koston për paga për çdo orë.

Numri i bizneseve në grupin e prekur (shprehur më lart si popullata) duhet të identifikohet qartë.

Shumica e vlerësimeve supozojnë një ‘popullsi’ statike biznesi. Në praktikë, ‘popullata’ e biznesit ka të ngjarë të ndryshojë me kalimin e kohës, por përpjekja për të modeluar një ‘popullsi’ dinamike biznesi rrezikon të sjellë pasiguri shtesë në modelim, nëse nuk ka arsye për të qenë të sigurt rreth hyrjes dhe daljes së mundshme për ‘popullatën’ në fushëveprim.

Sa i përket **frekuencës** është e rëndësishme të përcaktohet nëse aktiviteti administrativ përkatës zhvillohet në intervale të caktuara (ditore, javore, mujore, dyvjeçare, vjetore etj.), në varësi të detyrimeve që sjell rregullimi.

Më poshtë jepet një shembull i thjeshtë për të treguar se si të vlerësohen ndikimet.

Politika: Kryerja e trajnimeve të detyrueshme për sigurinë në punë për menaxherët e nivelit të lartë të bizneseve (2 orë në vit).

Për të kryer vlerësimin e ndikimeve të pritshme ndaj bizneseve të prekura duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm:

- *Identifiko grupet e prekura: të gjitha bizneset në Shqipëri.*
- *Kuantifiko numrin e bizneseve që preken në Shqipëri: 100 000 biznese.*
- *Përcakto kundërfaktorin: a ka biznese që e kryejnë ndërkohë këtë trajnim për menaxherët e nivelit të lartë? Po, - 50% (50 000 biznese).*
- *Kuantifiko numrin e bizneseve që janë objekt i politikës ('on scope'): $100\ 000 * 50\% = 50\ 000$ biznese.*
- *Identifiko llojet e ndikimeve:*
 - *Koha që u duhet menaxherëve për t'u familjarizuar me rregullimin e ri – kosto 'një herë';*
 - *Koha që shpenzojnë menaxherët e lartë në trajnim – kosto e vazhduar;*
 - *Kostot e kursit – kosto e vazhduar;*
 - *Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë në punë – përfitim në vazhdim;*
- *Kuantifiko llojet e përfitimeve:*
 - *Koha që u duhet menaxherëve për t'u familjarizuar me rregullimin e ri – 1 orë ;*
 - *Koha që shpenzojnë menaxherët e lartë në trajnim – 2 orë/vit;*

- *Kostot e kursit – 100 lekë;*
- *Vendos vlera të monetarizuara:*
 - *Koha që u duhet menaxherëve për t’u familjarizuar me rregullimin e ri – kostoja mesatare e punës për orë për menaxherët e nivelit të lartë, 11.9 lekë (10 lekë paga mesatare + 18.8% kostot përtej pagës).*
 - *Koha që shpenzojnë menaxherët e lartë në trajnim – kostoja mesatare e punës për orë për menaxherët e nivelit të lartë, 11.9 lekë (10 lekë paga mesatare + 18.8% kostot përtej pagës).*
 - *Rritja e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore – nuk mund të vlerësohet sasiore.*
- *Përdor Modelin e Kostos Standarde për të monetarizuar kostot:*
 - *Llogarisim koston totale të kohës që menaxherët shpenzojnë për familjarizim duke shumëzuar koston e punës së tyre/orë me kohën që harxhojnë për familjarizim dhe me numrin e menaxherëve: $1 \cdot 11.9 \cdot 50\,000 = 594\,000$ lekë;*
 - *Për të llogaritur koston e pjesëmarrjes në trajnim, shumëzojmë pagën e tyre/orë me kohën që shpenzojnë në kurs/trajnim dhe me numrin e menaxherëve: $2 \cdot 11.9 \cdot 50\,000 = 1\,188\,000$ lekë.*
 - *Për të llogaritur kostot totale të kursit, shumëzojmë koston për kursin me numrin e menaxherëve: $100 \cdot 50\,000 = 5\,000\,000$ lekë.*
 - *Më tej, shumëzojmë shumën e kostos totale të pjesëmarrjes në trajnim me koston totale të kursit me 10 vjet dhe kësaj i shtojmë koston e familjarizimit për të përfunduar ndikimin total: $(1\,188\,000 + 5\,000\,000) \cdot 10 + 594\,000 = 62\,474\,000$ lekë.*

Llogaritjet më poshtë ilustrojnë hapat e mësipërm.

<i>Numri i bizneseve të prekura</i>	<i>Rregulli mi për kostot përtej pagës</i>	<i>Kosto e kursit</i>		
50,000	18.8%	100 Lekë		
<i>Kosto ‘vetëm një herë’ - Familjarizimi</i>				
<i>Nr. i orëve i kërkuar për kompani</i>	<i>Kostoja e punës/orë (në lekë)</i>	<i>Kostoja e punës/orë e rregulluar në</i>	<i>Kostot/kompani (në lekë)</i>	<i>Kostot e agreguara (në lekë)</i>
1	10	11.9	11.9	594,000
<i>Kostot e vazhdueshme – Koha e shpenzuar për kursin</i>				
<i>Nr. i orëve i kërkuar për kompani</i>	<i>Kostot e punës/orë (në lekë)</i>	<i>Kostoja e punës/orë e rregulluar (në lekë)</i>	<i>Kostot/kompani (në lekë)</i>	<i>Kostot e agreguara (në lekë)</i>
2	10	11.9	23.8	1,188,000
<i>Kosto të vazhdueshme – kostoja e kursit</i>				
	<i>Kostoja e kursit (në lekë)</i>	<i>Kostot/kompani (në lekë)</i>	<i>Kostot e agreguara (në lekë)</i>	
	100	100	5,000,000	

<i>Opsioni 1 – Vlerësimi në lekë</i>										
	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>	<i>2024</i>	<i>2025</i>	<i>2026</i>	<i>2027</i>
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>	<i>7</i>	<i>8</i>	<i>9</i>	<i>10</i>
<i>Kostot për biznesin – ‘vetëm një herë’</i>	594,000									
<i>Kostot për biznesin – Të vazhdueshme</i>	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000
<i>Kostot totale për biznesin</i>	62,474,000									

Kursime në kosto dhe përfitime

Nëse propozimi rezulton me përfitime në formën e kursimeve në kosto, duhet të ndiqen të njëjtat metodologji për llogaritjen si ato për kostot e përdorura më lart.

- Kurdoherë që një opsion i politikës çon në uljen e tarifave rregullatore, duhet të ndiqet e njëjta qasje si në metodologjinë për vendosjen e tarifave për të vlerësuar vlerën e zvogëluar të kostos.
- Kurdoherë që një opsion i politikës çon në reduktim të kostove të politikave dhe/ose ngarkesave administrative, duhet të ndiqet e njëjta qasje si në metodologjinë e kostove të politikës dhe barrës administrative për të vlerësuar vlerën e zvogëluar të kostos.

Lloje të tjera të përfitimeve

Përveç kursimeve në kosto, opsionet e politikave mund të çojnë gjithashtu në lloje të tjera përfitimesh si për shembull përmirësimin e rezultateve të punësimit, rritjen e prodhimit dhe përfitime mjedisore e në shëndet.

Në këtë fazë, të gjitha përfitimet, përveç kursimeve në kosto, duhet të vlerësohen në mënyrë sasiore dhe/ose cilësore. VN duhet të bëjë një përshkrim të plotë të mënyrës, sipas së cilës do të dorëzohen efektet e dëshiruara. Duhet gjithashtu të përfshijë kuantifikim të ndikimeve jo të monetizuara për të dhënë disa informacione mbi shkallën e çështjes. Nëse sasiortja është gjithashtu e pamundur, efektet duhet të diskutohen të paktën në mënyrë cilësore.


Skontimi dhe vlera e ardhshme neto

Të gjitha ndikimet e monetizuara duhet të skontohen me faktorin e skontimit. Kostot dhe përfitimet duhet të kombinohen për të përfituar vlerën aktuale neto.

Për të marrë një vlerësim të arsyeshëm të kostove totale të një rregullimi/politike është e nevojshme të krahasohen ndikimet gjatë një periudhe relativisht të gjatë kohore. Skontimi është një teknikë e përdorur për të krahasuar kostot dhe përfitimet që ndodhin në periudha të ndryshme kohore. Ajo bazohet në parimin se, në përgjithësi, njerëzit preferojnë të marrin mallra dhe shërbime tani dhe jo më vonë. Kjo njihet si "preferenca e kohës".

Norma e skontimit përdoret për të kthyer të gjitha kostot dhe përfitimet në "vlera aktuale" në mënyrë që ato të krahasohen. Norma e rekomanduar e skontimit është 3.5%. Llogaritja e vlerës aktuale të diferencës midis kostove dhe përfitimeve jep vlerën aktuale neto të një opsioni.

Ekuacioni i vlerës aktuale neto është si vijon:



Vlera aktuale neto është një vlerë e vetme që përmbledh vlerën aktuale të ndikimit të përgjithshëm të rregullimeve apo politikave. Nëse është pozitive, përfitimet janë më të mëdha se kostot dhe nëse është negative, kostot janë më të mëdha se përfitimet. Vlerësimet duhet të bëhen për periudhën e jetës të politikës. Kur një periudhë vlerësimi e përshtatshme nuk është e qartë ose e njohur, duhet të përdoret një periudhë vlerësimi të paktën 10-vjeçare.

Në tabelën më poshtë jepet një shembull për të ilustruar skontimin dhe vlerën aktuale neto.

Politika: Kryerja e trajnimeve të detyrueshme për sigurinë në punë për menaxherët e nivelit të lartë të bizneseve (2 orë në vit).

Sipas këtij shembulli, pasi monetarizohen kostot dhe vlerësohet që është e pamundur të monetarizohen përfitimet, atëherë kostot duhet të skontohen (përfitimet gjithashtu, por në këtë rast janë zero meqë janë të pamundura për t'u monetarizuar) për të llogaritur vlerën aktuale dhe më tej vlerat aktuale të mëposhme.

Norma 3.5%

OPSIONI I - Vlerësimi											
	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
Faktori i skontimit	1	0.952835	0.907894	0.865073	0.824271	0.785394	0.748351	0.713055	0.679423	0.647378	
Kostot për biznesin – "një herë"	594,000										
Kostot për biznesin – të vachtueshme	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	
Kostot total	6,782,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	6,188,000	
Kostot total që skontuara	6,782,000	5,896,141	5,618,048	5,353,071	5,100,591	4,860,020	4,630,796	4,412,383	4,204,272	4,005,976	
Përfitimet total	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Përfitimet total që skontuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Total Vlera aktuale e Përfitimit	0										
Total Vlera aktuale e Kosos	50,863,297										
Vlera aktuale neto (VAN)	-50,863,297										

Kufizimet e analizës

VN duhet të ofrojë dëshmi për të mbështetur supozimet dhe të identifikojë qartë çdo boshllëk në prova apo të dhëna prandaj fuqia e supozimeve duhet të diskutohet në mënyrë cilësore për të ndihmuar lexuesit të vlerësojnë besueshmërinë e rezultateve. Duhet gjithashtu të përshkruani se çfarë mund të parandalojë realizimin e përfitimeve, të fryjë kostot ose të shkaktojë rezultate të paparashikuara.

Jep rekomandime në bazë të analizës

Siç është përmendur tashmë sa herë që përfitimet janë më të mëdha se kostot (vlerë aktuale neto pozitive), duhet të konsiderojmë rregullimet e planifikuara ligjore si të justifikuara. Megjithatë, mund të ketë raste që analiza e kosto - përfitimit të tregojë se ndërhyrja do të rezultojë në koston neto (vlerë aktuale neto negative); shpesh sepse është e pamundur të monetarizosh të gjitha llojet e përfitimeve. Politikëbërësit ende mund të marrin në konsideratë këto lloj ndërhyrjesh si të preferuara nëse, bazuar në analizën cilësore të ndikimeve jo të monetizuara, ata janë në gjendje të gjykojnë se përfitimi total i përgjithshëm (si ai i monetarizuar dhe jo i monetarizuar) tejkalon koston totale.

Kur vlerësohen dy ose më shumë opsione, opsioni me vlerën aktuale neto më të lartë duhet të rekomandohet për zbatim. Sidoqoftë, politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë edhe përfitimin total të përgjithshëm (si të monetarizuar dhe jo të monetarizuar) për opsionet e vlerësuara dhe, bazuar në analizën cilësore të ndikimeve jo të monetizuara, të bëjnë një gjykim mbi atë opsion që përfaqëson shumën më të lartë të përgjithshme.

Analiza e kosto - efektivitetit

Analiza e kosto - efektivitetit krahason kostot e opsioneve të ndryshme për të arritur rezultat të njëjtë ose të përafërt. Rezultatet që pritet të arrihen mund të jenë përfitime që ndonjëherë është e vështirë të kuantifikohen në terma monetarë, si p.sh.: vlera e jetës së gjësë së gjallë, përmirësimi i cilësisë së jetës etj.

Kjo metodë përdoret shpesh për programet shpenzuese të qeverisë. Pyetja tipike që merr përgjigje nga përdorimi i kësaj analize është: ‘Sa lekë do të shpenzohen për një vend pune të krijuar?’ Ose ‘Sa lekë do të shpenzohen për të shpëtuar një jetë?’.

Analiza e kosto-efektivitetit llogarit raportin kosto-efektivitet (Kostot e vlerës aktuale pjesëtuar për njësi të efektivitetit) të opsioneve të ndryshme të politikave dhe pastaj krahason këtë raport/përpjesëtim në mënyrë që të zgjidhet opsioni më kosto-efektiv. Kjo analizë rezulton e përshtatshme për t’u përdorur kur objektivat përcaktohen në detaje, siç është rasti kur ato janë pjesë e ndonjë dokumenti strategjik.

Analiza e kosto-efektivitetit funksionon më mirë kur ka një qëllim kryesor që duhet arritur dhe kur ky është i qartë. Kjo vlen kur ka një buxhet maksimal për të arritur një qëllim të caktuar që mund të alokohet dhe ky buxhet i përmbahet tavanit buxhetor të programit të ministrisë ose mbështetet nga buxheti shtesë përmes rialokimeve. Duhet të konsiderohet se buxheti duhet të mbulojë koston e vlerësuar për opsionin e zgjedhur përmes kësaj analize.

Hapat në analizën e kosto – efektivitetit

Analiza e kosto - efektivitetit përfshin hapat në vijim:

- 1 • Identifiko grupet e prekura
- 2 • Identifiko kostot dhe përfitimet për secilin grup
- 3 • Përcakto kostot
- 4 • Kuantifiko përfitimet në terma të efektivitetit
- 5 • Vlerëso kostot dhe përfitimet indirekte
- 6 • Skonto kostot e monetarizuara për të përftuar vlerën aktuale
- 7 • Llogarit raportin kosto - efektivitet
- 8 • Diskuto kufizimet e analizës
- 9 • Jep rekomandime bazuar në analizë


Si të përcaktojmë kostot në një analizë kosto-efektivitet

Meqenëse analiza e kosto - efektivitetit zakonisht përdoret për programet e shpenzimeve qeveritare, kostot i korrespondojnë shpenzimeve totale që shkaktohen nga kjo ndërhyrje. Kjo mund të përfshijë kostot fillestare, kostot e programit, koston e asistencës teknike, shpenzimet qeveritare (paga, ndërtesa, logjistikë). Të gjitha shpenzimet duhet të zbriten për të marrë vlerat aktuale siç përshkruhet në seksionin kosto-përfitim.

Raporti kosto-efektivitet

Ky raport vë përballë vlerën aktuale të kostos me njësitë e efektivitetit për të matur efektivitetin e opsioneve nën një emërues të përbashkët.

Ekuacioni i raportit kosto efektivitet:



Jep rekomandim bazuar në analizë

Në analizën e kosto-efektivitetit nuk ekziston një rregull i qartë për marrjen e vendimit për të zbatuar një opsion ose për ta refuzuar atë. Politikëbërësit duhet të përdorin gjykimin e tyre nëse kostoja për njësi e efektivitetit është mjaftueshëm e ulët për të marrë vendimin.

Kur vlerësohen dy ose më shumë opsione përkundrejt të njëjtave njësi të efektivitetit duhet të rekomandohet opsioni me raportin e efektivitetit më të ulët të koston për zbatim. Megjithatë, në mënyrë të ngjashme me analizën e kosto-përfitimit, politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë edhe rezultatet e pakrahasueshme dhe, bazuar në analizën cilësore të rezultateve që nuk është e mundur të kuantifikohen, të bëjnë një gjykim mbi atë opsion që ka raportin më të ulët të efektivitetit të koston.

Në tabelën më poshtë jepet një shembull i thjeshtë për të ilustruar se si të përdorim analizën e kosto –efektivitetit për të zgjedhur opsionin e preferuar.

Politika: Rritja e punësimit përmes programeve të punësimit dhe vetëpunësimit të ndërmarra si pasojë e këtij ndryshimi ligjor.

Shqipëria po konsideron dy opsione për të rritur punësimin. Ato janë:

- *Opsioni 1 - Të miratojë një projektligj të ri që krijon një model të ri të shërbimit të punësimin në vend;*
- *Opsioni 2 – Të ndryshohet ligji aktual për të përfshirë masa të tjera që përmirësojnë situatën.*

Në analizën e kosto – efektivitetit për të zgjedhur opsionin e preferuar duhen ndjekur hapat e mëposhtëm:

- *Identifiko grupet e prekura: qeveria, individët punëkërkues.*
- *Identifiko llojet e ndikimeve:*
 - *Shpenzime buxhetore*
 - *Rritje e punësimin*
- *Përcakto kostot:*
 - *Opsioni 1: 605 milionë lekë (të shpenzuara në një vit)*
 - *Opsioni 2: 700 milionë lekë (të shpenzuara në një vit)*
- *Kuantifiko përfitimet në njësi të efektivitetit:*
 - *Opsioni: 5000 punëkërkues përfitojnë nga ky program (në 1 vit)*
 - *Opsioni: 5000 punëkërkues përfitojnë nga ky program (në 1 vit)*
- *Llogarit raportin kosto-efektivitet; shih tabelën më poshtë:*

Opsionet	Kostot	Përfitimet	Raporti	Rezultatet
<i>Opsioni 1</i>	<i>605 milionë lekë</i>	<i>5000 punëkërkues përfitojnë nga ky program</i>	<i>0.121</i>	<i>121000 lekë do të shpenzohen në mënyrë që 1 punëkërkues të përfitojë nga programi.</i>
<i>Opsioni 2</i>	<i>700 milionë lekë</i>	<i>5000 punëkërkues përfitojnë nga ky program</i>	<i>0.14</i>	<i>140000 lekë do të shpenzohen në mënyrë që 1 punëkërkues të</i>

				përfitojë nga programi.
<ul style="list-style-type: none"> Jep rekomandime bazuar në analizë: <p>Analiza e kosto-efektivitetit tregon se opsioni I ka raportin më të ulët prandaj ky është opsioni i rekomanduar për zbatim.</p>				

Përmbledhje e analizës së kosto – përfitimit dhe kosto – efektivitetit

Tabela më poshtë përmbledh karakteristikat dhe dallimet kryesore midis këtyre dy llojeve të analizave:

Lloji i analizës	Kosto - përfitime	Kosto - efektivitet
Çështja kryesore e analizës	A janë përfitimet e një opsioni më të mëdha se kostot e tij?	Cili opsion do të rezultojë me nivelin më të lartë të efektivitetit për kosto të dhëna?
Matja e koston	Vlera monetare	Vlera monetare
Matja e përfitimeve	Vlera monetare	Njësi të efektivitetit
Pikat e forta	Mund të përdoret për të gjykuar mbi vlerën absolute të një opsioni	Nuk kërkon monetarizim të përfitimeve
Pikat e dobëta	Vështirësi në përcaktimin e vlerës monetare për të gjitha përfitimet relevante Mbështetet mbi besueshmërinë e supozimeve	Nuk mund të gjykojë vlerën absolute të një opsioni

Analiza me shumë kritere

Analiza me shumë kritere është shpesh metoda më e vështirë për krahasimin e opsioneve për ndërhyrje. Kjo analizë përdoret atëherë kur dy metodat e sipërpërmendura nuk rezultojnë të dobishme. Ajo lejon krahasimin e opsioneve të ndryshme të politikave në raport me disa kritere të paravendosura.

Analiza me shumë kritere aplikohet kur një politikë/projektakt synon të arrijë rezultate të shumëfishta ose rezultate shumë të ndryshme për nga natyra, ndërsa përfitimet dhe kostot kryesore nuk mund të shprehen në terma monetarë. Gjithashtu, mund të jetë e dobishme kur kostot dhe/ose përfitimet e opsioneve ndikojnë në grupe të caktuara në mënyrë jo proporcionale.

Shpesh vendimet që përgatiten bazuar në qasjen e kësaj analize janë të vështira për t'u shqyrtuar dhe mund të jenë shumë subjektive. Përmes analizës me shumë kritere krahasimi i kostove dhe përfitimeve na lejon të paraqesim ndikimet në mënyrë sasiore, cilësore dhe vlerë monetare në nivele të ndryshme detajimi.

Hapat në analizën me shumë kritere

Analiza me shumë kritere përfshin hapat e mëposhtëm:

1	•Përcakto kriteret
2	•Vendos peshën për secilin sipas rëndësisë relative
3	•Zgjidh shkallën e performancës
4	•Vendos pikë alternativave përkundrejt secilit kriter
5	•Kombino peshat me pikët për të arritur në vlerën totale
6	•Diskuto mbi kufizimet e analizës
7	•Rekomando në bazë të analizës

Kriteret, peshat dhe pikëzimi në analizën me shumë kriterë

Kriteret na lejojnë të vendosim se si të krahasojmë kontributet e opsioneve të ndryshme në përmbushjen e objektivave. Kjo kërkon zgjedhjen e kriterëve për të reflektuar performancën në përmbushjen e objektivave. Secili kriter duhet të jetë i matshëm, në kuptimin që duhet të jetë e mundur të vlerësohet, së paku në kuptimin cilësor, sa mirë pritet që një opsion i caktuar të performojë në lidhje me kriterin.

Një peshë specifike për çdo kriter pasqyron rëndësinë e kriterit në procesin e zgjedhjes së opsionit më të mirë. Ky proces përfshin përcaktimin e peshave numerike për të përcaktuar, për çdo kriter, vlerësimet relative të një ndryshimi sipas shkallës së zgjedhur të performancës. Kjo është një masë numerike që lidhet me një kriter që pasqyron se sa dy pikat referuese të kriterit ndryshojnë nga njëra-tjetra dhe se sa vendimmarrësi kujdeset për këtë ndryshim.

Pikëzimi përfshin vlerësimin e opsioneve përkundrejt kriterëve; pasojave të pritshme të secilit opsion u caktohet një rezultat numerik sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter.

Shkalla e preferencës (të dhënat reale të botës dhe gjykimet) janë përkthyer në shkallët e preferencës që përfaqësojnë vlerën relative të opsioneve. Në praktikë, përdoren shpesh shkallët që shtrihen nga 0 në 100, ku 0 përfaqëson një alternativë reale ose hipotetike më pak të preferuar dhe 100 është e lidhur me një alternativë reale ose hipotetike më të preferuar. Të gjitha opsionet e shqyrtuara në analizën me shumë kriterë janë midis 0 në 100. Vlerësimi në përgjithësi kërkon njohuri teknike të opsioneve dhe shpesh kryhet nga ekspertë teknikë ose grupe të rishikimit. Më poshtë jepet një shembull i përdorimit të analizës me shumë kriterë.

Politika hipotetike e përmirësimit të shëndetit të dhëmbëve.

Opsionet që merren në konsideratë janë:

- *Opsioni 1 - Të kryhet rregullim ligjor që i detyron kompanitë e ujit t'i vendosin më shumë fluoride ujit të pijshëm.*
- *Opsioni 2 – Të ndërmerren fushata ndërgjegjësimi për të inkurajuar njerëzit të lajnë dhëmbët rregullisht me pastë dhëmbësh me fluoride dhe të kryejnë vizita tek dentisti rregullisht.*
- *Opsioni 3 – Të kryhet rregullim ligjor për të detyruar të gjithë autoritetet lokale të ofrojnë vizita dentare falas për fëmijët që ndjekin shkollën.*

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- *Përcakto kriteret që tregojnë arritjen e objektivit për të përmirësuar shëndetin e dhëmbëve:*
 - *Efektiviteti në përmirësimin e shëndetit të dhëmbëve;*
 - *Aftësia për të adresuar probleme dentare ekzistuese;*
 - *Aftësia për të përmirësuar shëndetin e dhëmbëve të fëmijëve në shkolla;*
 - *Aftësia për të përmirësuar shëndetin e dhëmbëve në të gjitha rajonet;*
 - *Kostot (në këtë shembull opsioni që ka kosto më të ulët do të marrë më shumë pikë dhe e anasjellta);*
- *Vendosni peshën kritereve sipas rëndësisë relative:*
 - *Efektiviteti në përmirësimin e shëndetit të dhëmbëve: 4*
 - *Aftësia për të adresuar probleme dentare ekzistuese: 2*
 - *Aftësia për të përmirësuar shëndetin e dhëmbëve të fëmijëve në shkolla: 2*
 - *Aftësia për të përmirësuar shëndetin e dhëmbëve në të gjitha rajonet: 1*
 - *Kostot: 4*

- Zgjidhni shkallën e performancës: p.sh., nga 0 tek 5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.
- Vendosi pikë opsioneve përkundrejt secilit kriter – shih matricën e performancës më poshtë.
- Kombino peshat me pikët për të arritur në vlerën totale - shih matricën e performancës më poshtë.

Matrica e performancës

Kriteret	Pesha	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
<i>Efektiviteti në përmirësimin e shëndetit të dhëmbëve</i>	4	5 (20)	3 (12)	3 (12)
<i>Aftësia për të adresuar probleme dentare ekzistuese</i>	2	0 (0)	1 (2)	5 (10)
<i>Aftësia për të përmirësuar shëndetin e dhëmbëve të fëmijëve në shkolla</i>	2	5 (10)	2 (4)	5 (10)
<i>Aftësia për të përmirësuar shëndetin e dhëmbëve në të gjitha rajonet</i>	1	6 (6)	5 (5)	3 (3)
Kostot	4	6 (24)	4 (16)	2 (8)
Pikët		60	39	43

- Zgjidhni opsionin e preferuar bazuar në rezultatet e peshuara. Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni 1 (rregullimi i fluoridimit) është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar.

ANEKSET

Aneksi 1: Modeli Tip i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projekt ligj për
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e....
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim/Konsultim/Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva XXX e BE-së/Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	[Jepni titullin e strategjisë ose të dokumentit të politikave që ka të bëjë me projektligjin]
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	[Data/Asnjë konsultim publik]
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[Data e përfundimit të Vlerësimit të Ndikimit/Data kur është përgatitur versioni i fundit i Vlerësimit të Ndikimit]
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	XXXX

NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[Viti – ML-Nr. VN]
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT NË MINISTRI)	Emri, Mbiemri, e-mail-i dhe numri i telefonit:
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i>	
OPSIONET E POLITIKAVE <i>Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë alternativat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore si dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.</i>	
ANALIZA E NDIKIMEVE <i>Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.</i>	
ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR <i>Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.</i>	

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
p.sh. 300 000	p.sh. 300 000	p.sh. 100 000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohet zbatimi dhe monitorimi?

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin I/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës.*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*

- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
 - *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
 - *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
 - *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*
-
-
-
-
-
-
-
-
-
-
-
-

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
 - *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*
-
-
-

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit - aneksi 1/a

Tabelë: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										

Përfitimi për buxhetin – në vazhdim									
Përfitimi për biznesin – një herë									
Përfitimi për biznesin – në vazhdim									
Përfitimi për grupet e tjera – një herë									
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim									
Kosto për buxhetin – në vazhdim									
Përfitimi në total									
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës									
Vlera aktuale e kostos në total									
Vlera aktuale e përfitimit në total									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total									

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit - Aneksi 1/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milion lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			

Aneksi 2: Pyetje ndihmëse gjatë përgatitjes së VN-së

<i>Ndikimet dhe pyetjet specifike që duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së VN-së</i>	
Ekonomike (përfshirë ato financiare)	<ul style="list-style-type: none"> - A do të ndikojnë propozimet në bizneset, sektorin publik ose organizatat e shoqërisë civile? Si do të ndikojë kjo? Në veçanti, merrni parasysh ndikimet në bizneset e vogla. - A do të preken të gjitha bizneset në të njëjtën mënyrë apo do të ketë ndonjë që do të përfitojë, ndërsa të tjerët mbajnë kostot? - A do të preken të gjitha bizneset dhe konsumatorët? Cili do të jetë ndikimi në NVM-të dhe ndërmarrjet e reja fillestare? - A do të ketë kosto shtesë për sektorin publik për të implementuar dhe zbatuar politikën? - A është krijuar ndonjë autoritetet ose funksion i ri publik me kosto dhe barrë shtesë për sektorin publik? - Cila do të jetë kostoja shtesë për ministrinë dhe/ose institucionet e tjera të sektorit publik (duke përfshirë kostot e zbatimit, monitorimit dhe të vlerësimit)?

	<ul style="list-style-type: none"> - Cilat janë përfitimet / kursimet për sektorin publik? - Cila do të jetë kostoja dhe barra shtesë mbi biznesin, e tillë si kostoja e punësimit (duke përfshirë edhe atë për NVM-të)? - A do të ketë një ndikim më të gjerë në tregun e punës? - A ka kërkesa ose rregulla shtesë (të reja) për investime që kanë të bëjnë me funksionimin e bizneseve (përfshirë NVM-të)? - A do të rezultojë propozimi në shpenzime shtesë operative (ose kursime) për bizneset (përfshirë NVM-të)? - A do të ndikojë propozimi në të drejtat e pronave/teknologji/inovacion në ekonominë më të gjerë ose sektorë të veçantë? - Cili është ndikimi mbi konkurrencën ekonomike dhe hyrjen e investimeve në vendit dhe në fusha dhe sektorë të caktuar të ekonomisë? - A ka të ngjarë të ketë pasoja ose ndikime të nivelit të lartë në mjedisin makroekonomik, në kushtet e rritjes ekonomike dhe në produktivitetin?
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> - A do të ndikojë politika mbi mjedisin e biznesit dhe tërheqjen e ekonomisë dhe do të ndikojë ajo në tregti? - Cilat janë ndikimet e mundshme mbi konkurrencën në treg dhe mbi disponueshmërinë dhe numrin e furnitorëve në tregje? A do të kufizojnë apo do të nxisin hyrjen e lojtarëve të ri në një sektor, treg apo fushë ekonomike specifike? - Etj.
<p>Sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - A do të ketë propozimi ndikim në shëndetin e mirëqenien e grupeve të caktuara apo në pabarazitë shëndetësore dhe si? - A do të ketë ndikim në punësimin dhe tregun e punës? - A do të ketë ndikim në rritjen ose reduktimin e rrezikut të korrupsionit në sektorin publik? - A do të ndikojë propozimi në sigurinë në punë ose a do të ndikojë ai në ndodhjen e aksidenteve në komunitet? - A do të ndikojë propozimi në normat e krimit apo parandalimin e krimit apo do të krijojë një vepër të re/mundësi për krim?

	<ul style="list-style-type: none"> - A do të ndikojë propozimi në nivelet e aftësive dhe të arsimit? - A do të ndikojë propozimi në ofrimin e mjediseve ose shërbimeve që mbështesin kohezionin e komunitetit apo në mënyrat e tjera që ndikojnë në cilësinë e jetës në komunitetin lokal? - A do të ndikojë propozimi në mënyrë të tillë që zonat rurale të jenë të ndryshme nga zonat urbane? - Cilat janë ndikimet në të drejtat e njeriut (e drejta për jetën, lirinë dhe sigurisë, në gjykimin e drejtë dhe ndalimin e torturës, skllavërisë, punës së detyruar)? - Etj.
Mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> - A do të çojë propozimi në ndryshime të emetimit të gazrave serë? - A do të jetë propozimi i ndjeshëm ndaj efekteve të parashikuara të ndryshimit të klimës? - A do të çojë në një ndryshim të kostove financiare ose ndikimeve mjedisore dhe shëndetësore të menaxhimit të mbetjeve? - A do të ndikojnë dukshëm në cilësinë e ajrit?

	<ul style="list-style-type: none">- A do të përfshijë ndryshime materiale në pamjen e peizazhit apo në pamjen e qytetit?- A do të ndryshojë shkallën e ndotjes së ujit; nivelet e nxjerrjes së ujit; ekspozimin ndaj rrezikut të përmbytjeve?- A do të shqetësojë ose do të rrisë habitatet apo kafshët e egra?- A do të ndikojë në numrin e njerëzve të ekspozuar ndaj zhurmës ose ndaj niveleve të ekspozimit?- A do të ndikojë në reduktimin e mbrojtjes dhe sigurisë ushqimore të njerëzve dhe kafshëve?- A do të ndikojë në mbrojtjen nga efektet e organizmave të modifikuar gjenetikiisht?- A do të çojë propozimi në rrezikun e dëmtimit nga efektet e kimikateve apo të instalimeve të dëmshme industriale?- Etj..
--	--

Aneksi 3: Ndikimi në testin e NVM-ve

Pyetje orientuese me qëllim reflektimi për ministritë e linjës për të vlerësuar ndikimin ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).

Nr.	Testi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	Po/Jo	Shënime
1	A do të ketë rregullimi efekt mbi ekonominë dhe mbi sektorët e veçantë të ekonomisë?		
2	A do të ndikojë rregullimi në performancën ekonomike të sektorit (p.sh. në prodhim, punësim, produktivitet, investimet etj.)?		
3	A do të imponojnë rregullimi kosto shtesë rregullatore në sektor?		
4	Do të ndikojë rregullimi në konkurrencën e sektorit?		
5	A do të ndikohet performanca ekonomike e sektorit të NVM-ve nga rregullimi?		
6	A do të imponojnë rregullimi kosto shtesë rregullatore për NVM-të?		
7	A do të ndikojë rregullimi në aftësinë konkurruese të NVM-ve?		

8	A do të ketë rregullimi një ndikim të rëndësishëm në mikrondërmarrjet?		
---	--	--	--

Aneksi 4: Ndikimi në testin e konkurrencës

Pyetje orientuese me qëllim reflektimi për ministritë e linjës për të vlerësuar ndikimin te konkurrenca

Testi i konkurrencës	Po/Jo	Shënime
A do të ndikojë rregullimi drejtpërsëdrejti në kufizimin e numrit apo gamës së bizneseve? A do ta vështirësojë futjen në treg të bizneseve të reja një prej opsioneve të parashikuara?		
A do të ndikojë njëri prej opsioneve drejtpërsëdrejti në kufizimin e numrit të bizneseve?		
A do të kufizojë njëri prej opsioneve kapacitetin e bizneseve për të konkurruar?		
A do të zvogëlojë njëri prej opsioneve stimujt e bizneseve për të konkurruar në treg?		

Aneksi 5: Listë kontrolli për përdorim nga njësia e VN-së në Kryeministri

<p>Kërkesat minimale në fazën e fundit, kur propozimi i politikave dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave</p>	<p>VN</p>
<p>Përcaktimi i problemit të politikave: Diskutimi i problemit të politikave që kërkon ndërhyrjen e qeverisë. Cili është problemi që politika synon të trajtojë? Cili është dështimi i tregut apo i qeverisë apo cilat janë çështjet e tjera të nivelit të lartë që janë duke u trajtuar? Përshkrimi i situatës ekzistuese dhe pse problemi nuk mund të eliminohet pa ndërhyrje.</p>	<p><input checked="" type="checkbox"/></p>
<p>Objektivat e politikave: Pse është e nevojshme kjo pjesë e legjislacionit ose propozim politik? Është dhënë përcaktimi i qartë i objektivit të politikës. Ka një diskutim se si politika do të kontribuojë në drejtim të prioriteve të nivelit të lartë të qeverisë dhe në drejtim të procesit të integritimit në BE. Diskutimi i rezultateve dhe qëllimet përfundimtare të ndërhyrjes.</p>	<p><input checked="" type="checkbox"/></p>

<p>Pse duhet të ndërhyjë qeveria? Është dhënë arsyetim i qartë për nevojën e ndërhyrjes së qeverisë. Analiza duhet të japë përgjigje se pse ndërhyrja është e nevojshme tani.</p>	<input checked="" type="checkbox"/>
<p>Analiza dhe diskutimi është strukturuar dhe është paraqitur në mënyrë të qartë në raportin e VN-së; të dhënat dhe informacionet e paraqitura janë nga burime të besueshme.</p>	<input checked="" type="checkbox"/>
<p>Identifikimi dhe diskutimi i opsioneve për të trajtuar objektivat e politikës (duke përfshirë një opsion jorregullator kur është e mundur). Diskutimi i situatës pa ndërhyrjen e qeverisë ("Status quo-ja").</p>	<input checked="" type="checkbox"/>
<p>Analiza e ndikimeve: Identifikimi i grupeve kryesore (fitues dhe humbës) të prekur në çdo opsion. Diskutime cilësore të ndikimit të grupeve të prekura (publike, private dhe të sektorit të tretë). Diskutimi sasior i ndikimit, ku është e mundshme (do të preken p.sh. 1,000 NVM). Analiza dhe raportimi i të paktën kostove në total të drejtpërdrejta të propozimeve. Diskutimi i përfitimeve (cilësore). Diskutimet e risqeve dhe pasojave, duke përfshirë ndikimin/mbështetjen e mundshme për masat antikorrupsion.</p>	<input checked="" type="checkbox"/>
<p>Diskutimi i ndikimeve të drejtpërdrejta (kostot dhe përfitimet) dhe pasojat dhe risqet e mundësive të politikave të zgjedhura.</p>	<input checked="" type="checkbox"/>
<p>Problemi, objektivat dhe opsionet. Analiza dhe prezantimi i zgjeruar, më rigoroz dhe në thellësi i problemit të politikës, arsyetimi i ndërhyrjes së qeverisë, i objektivave të politikave dhe i</p>	<input checked="" type="checkbox"/>

opsioneve. Përdorimi i një game të gjerë të mjeteve dhe teknikave analitike, të tilla si SËOT dhe i metodologjive të vlerësimit të opsioneve.	
Analiza e ndikimeve: Analiza më rigoroze e ndikimeve (të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta) të propozimeve të politikave. Vlerësimi sasior i kostove të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta dhe përpjekjet për të monetarizuar disa ndikime të drejtpërdrejta. Analiza e ndikimeve për një periudhë të paktën 3 - 5-vjeçare. Përmbledhje e kostove dhe përfitimeve në total dhe prezantimi në termat e Vlerës Aktuale Neto. Analiza e veçantë e kostove administrative dhe e politikave.	<input checked="" type="checkbox"/>
Analiza shtesë në thellësi e ndikimeve të veçanta për NVM-të, ndikimi në mjedis, ndikimi social, ndikimin mbi konkurrencën dhe tregun, vlerësimi i risqeve antikorrupsion.	<input checked="" type="checkbox"/>
Një seksion i veçantë që diskuton çështjet dhe risqet e zbatimit.	<input checked="" type="checkbox"/>
Një plan dhe metodologji të qartë për shqyrtimin dhe vlerësimin e politikave pas zbatimit (pas 3-5 vjet).	<input checked="" type="checkbox"/>

